



## DREJTËNJË “PAXLINGUISTICA” NË KOSOVË?

## Fjala e redaktorit



Ky është një edicion special i Buletinit të rregullt ASI. Pasi që njerëz të bashkësive të ndryshme që flasin gjuhë të ndryshme kërkojnë të kenë qasje në institucionet publike, zhvillimi i një kulture dhe një praktike për një shumëgjuhësi ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Viti 2005 është një vit vendimtar për ardhmërinë e Kosovës. Zbatimi i standardeve me përparësi është bërë një preokupim i të gjithëve dhe Kosova mund të llogarisë në ndihmen dhe ekspertizën e shumë njerëzve. Ky edicioni i ASI-t është reflektim i këshillave të ekspertëve që u ofrohen liderëve të institucioneve të Kosovës, shërbimit civil, përfaqësuesve të bashkësive, shoqërisë civile dhe mediave.

Më 14 dhe 15 shtator të vitit 2004 Misioni i OSBE-së në Kosovë në bashkëpunim me Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) organizuan konferencën me emrin "Drejt një Pax Linguistica në Kosovë? Të drejtat gjuhësore të bashkësive të Kosovës" mbi zbatimin e të drejtave gjuhësore në Kosovë. Tema qëndrore e paraqitjeve ishte rëndësia e promovimit të llojllojshmërisë gjuhësore si njëri nga mjetet për përparimin e mirëkuptimit, tolerancës dhe integritit në shoqëri. Për më tepër, siguri i të drejtave gjuhësore për bashkësitë etnike të Kosovës është kërkesë e Planit për Implementimin e Standardeve për Kosovën (PISK). Qëllimi i këtij edicioni të Buletinit ASI është vazhdimi i debatit për nevojën e përmirësimit të zbatimit të politikës së përdorimit të gjuhës në Kosovë dhe të "tregohet se ç'përmbanë rruga përpara", identifikimi i zgjidhjeve të mundëshme dhe dhënia e rekomandimeve.

Në konferencë të pranishëm ishin ekspertët kryesorë për të drejtat e pakicave dhe për gjuhët e pakicave. Në mesin e tyre ishte edhe Fernand de Varennes, ligjërues për të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare në Univerzitetin Murdoch (Murdoch) të Australisë. (shih artikullin e tij "Gjetja e një balansi në mes të kërkesave të pakicave për të drejta dhe burimeve qeveritare"), i cili është i njohur në tërë botën për punën e tij në këtë temë.

Shumica e problemeve me të cilat ballafaqohen bashkësitë etnike të Kosovës në ushtrimin e të drejtave të tyre gjuhësore kanë të bëjnë me qasjen në informatat e shkruara dhe në komunikim me institucionet e Kosovës si në nivelin qendrorë ashtu edhe në atë komunal. Mungesa e shërbimeve për përkthim dhe mungesa e përkushtimit të zyrtarëve të IPVQ ishin shkaqet që u paraqiten më së shpeshti. Si shtesë, gjithashtu mungesa e madje në disa raste edhe mosekzistimi shenjave të rrugëve, udhëve dhe shenjave tjera publike në disa pjesë të Kosovës në gjuhët e pakicave (në gjuhën serbe dhe në gjuhët tjera ku është e mundur që kjo gjë të jetë e zbatueshme) është përmendur si diçka frustruese për bashkësitë e pakicave dhe është interpretuar si një problem teknik por edhe si një politikë që brengosë.

Përfundim i konferencës ishte se frustrimet që kanë të bëjnë me gjuhën për bashkësitë e pakicave kanë bazën e tyre në zbatimin joadekuat të kornizës së aplikueshme ligjore dhe kjo në masë të madhe vjen për shkakun se mungon të kuptuarit e qartë dhe uniform të ligjit të aplikueshëm.

Tri shkrimet e para në këtë buletin hulumtojnë në thellësi çështjet e shpeshta të zbatimit të politikës gjuhësore, çështje kjo që u ngritë në konferencë, ngatërresat gjatë përkthimeve në procesin e hartimit të ligjeve (shih shkrimin 'Humbjet gjatë përkthimit' ose si t'ia bëjmë që tri gjuhë të flasin me një zë legjislativ"), për nevojën e menjëherëshme për përmirësimin e zbatimit të politikës gjuhësore nga komunat (shih shkrimin Vlerësim i implementimit të politikës gjuhësore në praktikën komunale) si dhe nevojën për një qasje të duhur të qeverisë në sigurimin e arsimimit të duhur në gjuhët amtare (shih "Arsimimi multietnik").

Secili nga shkrimet e lartpërmendur jep rekomadimet se si të iu qasemi drejtpërsëdrejti problemeve të identifikuar. Këto rekomadime janë të plotësuar me tri shkrimet të cilat kanë një qasje gjithëpërfshirëse dhe sqarojnë se si të ndërtohet dhe si zbatohet një politikë e duhur gjuhësore mbarë-kosovare. Njëri shkrim flet për shembullin pozitiv të Ligjit kundër Diskriminimit dhe cilët janë hapat që duhet të ndërmerren për sigurimin e të drejtave gjuhësore (shih "Ligji kundër diskriminimit – futja e sektorit privat"). Një tjetër jep fakte pozitive për të pasur një ligj për përdorimin e gjuhëve (shih "Elementet e një Ligji mbi Përdorimin e Gjuhës"). Shkrimi përfundimtar nga Dr. De Varennes, sqaron racionalitetin mbrapa politikës qeveritare për gjuhët që janë dëshmuar si të suksesshme në vendet e tjera duke ofruar një formulë prej katër parimesh udhëheqëse (shih "Gjetja e një balansi në mes të kërkesave të pakicave për të drejta dhe burimeve qeveritare").

Shpresojmë se këto analiza, propozimi për një projekt-ligj për përdorimin e gjuhës dhe sygjerimet e tjera për këtë çështje do të jenë të dobishme për juve. Si përherë ne mirëpresim komentet e juaja.

*Franklin De Vrieze,  
Kordinator i ASI-t*

# ‘Humbjet gjatë përkthimit’ ose si t’ia bëjmë që tri gjuhë të flasin me një zë legjislativ

Problemet e mëdha rreth përkthimit pengojnë procesin legjislativ. Mospërputhjet e mëdha në mes të verzioneve të obligueshme të teksteve ligjore, pra ato në anglisht, shqip dhe serbisht, largojnë mendjen nga përmbajtja e ligjit, krijojnë huti dhe pengojnë zbatimin e suksesshëm të ligjit. Arsytet kryesore mbrapa tërë kësaj janë mungesa e përkthyesëve të kualifikuar (për anglisht), përkushtimi i pamjaftueshëm politik (për verzionet serbisht), procedurat joefikase për përkthim dhe “ngutia legjislative”.

Zgjedhjet afatshkurtura të rekomanduara mund të jenë përmirësimi i menaxhimit të zyrave të përkthimit, nënkontraktimi i përkthimeve në gjuhën angleze dhe standardizimi i termave ligjor që janë në përdorim. Në planin afatmesëm autorët sygjerojnë që IPVQ të konsideroj mbajtjen e orëve të mësimi të gjuhës për të gjitha gjuhët zyrtare për të gjithë shërbimin civil, e në ndërkohë të zvogëloj në minimum nevojën për përkthime në anglisht. Krijimi i një instituti për përkthime është njëra nga gjërat që parashihen në planin afatgjatë.

Ulrich Steinle, Zyrtar i programit, Ekipi për përkrahjen e qeverisjes qendrore, Misioni i OSBE-së në Kosovë  
Senad Šabović, Ekipi për përkrahjen e qeverisjes qendrore, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Përkthimi i teksteve ligjore në procesin legjislativ duhet të përmirësohet urgjentisht. Shumëgjuhësia është thelbësore për funksionimin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ). Me shumëgjuhësi nën-kuptohet se Kosova i ka tri gjuhë zyrtare: gjuhën shqipe, serbe dhe atë angleze. Sidoqoftë ekzistojnë dispozita ligjore, ndonëse të paqarta, mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve të tjera në komuna me prezencë përmbajtësore të përfaqësuesve nga komunitetet e tjera gjuhësore. Shumëgjuhësia rrjedhimisht del si kërkesë e obligueshme ligjore që këto gjuhë të shfrytëzohen në të gjitha aspektet e qeverisjes dhe administrimit.<sup>1</sup>

Një aspekt i dispozitave ligjore mbi shfrytëzimin e të gjitha gjuhëve zyrtare, megjithatë është posaçërisht i vështirë për t’u implementuar. Vërtetë, përkthimi i projektligjeve, amandamenteve dhe teksteve të tjera ligjore të prodhuara nga Kuvendi i Kosovës gjatë mandatit të parë të tij nga viti 2001 deri më 2004 ka hasur në të meta të mëdha. Vlerësohet se 60-80% e amandamenteve të projektligjeve të propozuara në

Kuvend nuk i adresojnë çështjet përmbajtësore të ligjeve për shkak të papërshtatshmërisë të gjuhës. Kjo është qartë një shpërdorim i resurseve nëse anëtarët e Kuvendit duhet të merren me redaktimin e teksteve ligjore dhe jo me shqyrtimin e aspekteve më përmbajtësore të projektligjeve të propozuara.

Përkundër situatës politike relativisht ende të nxehtë në Kosovë sa i përket marrëdhënieve ndëretnike, gjë që natyrisht reflektohet edhe në Kuvendin e Kosovës dhe institucionet e tjera të qeverisjes, problemet me përkthimin e teksteve ligjore nuk janë aq rrjedhojë e dallimeve politike, por më tepër nga mangësitë të cilat përgjithësisht mund të cilësohen si ‘teknike’. Për këtë arsye, teksti në vijim do të tentojë të ofrojë një përmbledhje të shkurtër mbi problemet kryesore që janë vërejtur në procesin e përkthimeve ligjore, si edhe t’i identifikojë zgjidhjet e mundshme afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata të këtyre problemeve.

***Cilat janë problemet e ndërlydhura me përkthimin në procesin legjislativ?***



*Sesion i Kuvendit të Kosovës (mandati i kaluar)*

Një nga mangësitë kryesore është mungesa e përkthyesëve dhe interpretuesëve të kualifikuar në IPVQ. Kjo mungesë, e cila më parë mund të klasifikohet si mungesë e natyrës teknike se sa asaj politike, ka të


bëjë posaçërisht me kapacitetet e përkthimit në gjuhën angleze, mirëpo edhe në gjuhën serbe. Vërtetë, përkthimi i mirë është një shërbim që ofrohet në sasi të pamjaftueshme në Kosovë. Përkthyesit e kualifikuar dhe

<sup>1)</sup> Për qëllime të këtij artikulli, theksi do të vihet në vështirësitë të cilat kanë të bëjnë me përkthimin ligjor në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Megjithatë duhet të theksohet se është befasues fakti që as madje edhe dokumentet më thelbësore të IPVQ-ve, si p.sh. Rregullorja e Përkohshme e Punës së Kuvendit të Kosovës, nuk përkthehen në gjuhët e tjera, si p.sh. në atë turke.

profesional të gjuhës angleze, me përvojë dhe njohuri të çështjeve ligjore, janë të paktë. Përveç kësaj, rrogat e ofruara për përkthyesit e IPVQ-ve sipas kushteve të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (KKB) vështirë se mund të jenë tërheqëse për ata pak përkthyesë ligjorë.

Për këtë arsye shumica e përkthyesëve të kualifikuar të gjuhës angleze punojnë për organizatat ndërkombëtare dhe jo për IPVQ-të/Kuvendin e Kosovës. Në anën tjetër, shumë nga projektligjet ose shkruhen në gjuhën angleze ose janë dukshëm të ndikuara nga folësit e gjuhës angleze (për shembull, ekspertët ndërkombëtarë të grupeve punuese për projektligjet), dhe ato duhet të përkthehen në gjuhën shqipe ose serbe nga shërbimi i përkthyesëve të IPVQ-së. Rrjedhimisht, përkthimi i teksteve origjinale në gjuhën angleze shpesh nuk e ka cilësinë e duhur dhe përmban gabime gjuhësore. Disa nga gabimet madje edhe projektohen në përkthimin në gjuhën e dytë zyrtare, gjë që paraqitet, për shembull, kur një pjesë e përkthimit jo të saktë nga versioni në gjuhën shqipe përkthehet në gjuhën serbe nga përkthyesit të cilët e shfrytëzojnë tekstin në shqip si version bazë.<sup>2</sup>

Sa i përket përkthimit në gjuhën serbe, nuk ekziston një përgjigje e prerë pse ekzistojnë aq shumë probleme në IPVQ pasi që supozohet se një numër i madh i kosovarëve mbi moshën 25 vjeçare e flasin mjaft mirë gjuhën serbe. Në këtë kontekst, problemet lidhur me përkthimin bëhen më tepër politike se sa teknike. Do të thotë, ka një mungesë të përkushtimit politik gjë që



*Përkthimi i dobët ndanë verzionet "identike" të të njëjtit ligj. Përmbajtja "humbet në përkthim".*

ekziston që nga konflikti dhe që nevojitet shumë për komunikim në gjuhën serbe përbrenda procesit legjislativ. Në të vërtetë, shumë shpesh versionet në gjuhën serbe të projektligjeve janë të cilësisë së dobët, siç ka ndodhur për shembull me Ligjin kundër Diskriminimit, i cili ishte refuzuar nga anëtarët serbë të Kuvendit jo për shkak të përmbajtjes, por për shkak të përkthimit të shtrembëruar në gjuhën serbe. Megjithatë, do të duhej të kishte mjaft përkthyes të aftë serbë me përvojë ligjore të cilët do t'i ofronin përkthimet profesionale nga shqipja në serbishte, madje edhe me kushtet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, po që se përkushtimi politik do të përmirësohej në mënyrë kuptimplote.

Përveç mungesës së kapacitetit dhe në disa raste edhe vullnetit të pamjaftueshëm politik, ekziston edhe problemi i mungesës së procedurave efikase të përkthimit për njësitë ekzistuese të

përkthimeve. Si shembull, nëse amandamentet e projektligjeve miratohen në komisionet e Kuvendit ose grupi punues i projektligjit ato integrohen në versionin gjuhësor të projektligjit për të cilin është propozuar amandamenti. Por, me gjasë shumë shpesh këto amandamente nuk përkthehen dhe integrohen në versionet tjera gjuhësore të njëjtit projektligj. Si pasojë, pas kalimit të projektligjit nëpër procesin legjislativ nuk ka vetëm një projektligj, por për tri projektligje të ndryshme, sepse versionet në tri gjuhët dallojnë mjaft në aspektin përmbajtësor. Ky është një problem që mund të tejkalohet me përmirësimin e menaxhimit të njërive të përkthimit dhe me miratimin e procedurave më të mira përbrenda vet procesit hartues. Është inkurajues fakti se kohëve të fundit ka pasur progres në këtë drejtim.

Në fund, ajo që mund të quhet si 'ngutësi legjislativ' – shpe-

jtësia me të cilën hartohen dhe përpunohen projektligjet nga Qeveria dhe Kuvendi – nuk është e vetmja arsye për përmbajtjen që ndonjëherë duhet të përmirësohet ligjeve, por gjithashtu edhe për shkak të përkthimit të dobët. Siç është përmendur më parë, shumë amandamente të projektligjeve në Kuvend më tepër i adresojnë gabimet gjuhësore se sa përmbajtjen e projektligjeve. Nëse do të kishte më tepër kohë në tërë procesin legjislativ, me siguri mund të argumentohet se ne do të ishim dëshmitarë të ligjeve të miratuara me cilësi më të lartë, pasi që përveç përmirësimit të cilësisë së përkthimit, Kuvendi i Kosovës gjithashtu do të kishte kohë që të përqendrohej në çështjet më përmbajtësore të projektligjeve që shqyrtohen.

***Cilat janë zgjidhjet e mundshme?***

Duke i pasqyruar mangësitë e përmendura, ne propozojmë

<sup>2</sup> Në këtë aspekt, duhet të theksohet se bashkësia ndërkombëtare kërkon nga IPVQ-të parashtrimin e projektligjeve të përkthyer në gjuhën angleze për t'u shpallur nga PSSP-ja. Pasi që nuk ka nevojë të vërtetë 'vendore' për tekstet ligjore në gjuhën angleze, mund të debatohet nëse kjo barrë me çdo kusht duhet të vihet në krah të IPVQ-ve për çdo projektligj. Mirëpo kjo është një çështje tjetër.

qëllime të politikave afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata për adresimin e këtyre problemeve.

Ne planin afatshkurtë, është absolutisht e domosdoshme që të përmirësohet menaxhimi i njësisë së përkthimeve të Kuvendit të Kosovës dhe IPVQ-ve. Një hap në këtë drejtim do të ishte futja në përdorim e mekanizmave të kontrollit të cilësisë, (korrektimi) dhe zbatimi i procedurave të standardizuara (si të përcillen ndryshimet në propozimet në gjuhë të ndryshme)

Sa i përket përkthimeve në gjuhën angleze, IPVQ-të gjithashtu do të mund ta fillonin kontraktimin e shërbimeve përkthyesive të jashtme. Me të vërtetë, pse mos të angazhohen kompanitë private për shërbime të përkthimit – siç është p.sh. rasti në Belgjikë? Kompanitë private mund të ofrojnë shërbime përkthimi më të lira dhe më profesionale, posaçërisht sepse ato janë në gjendje të paguajnë për përkthim profesional në anglisht, gjë që nuk është e mundur me kufizimet e BKK.

Përkthimi gjithashtu mund të përmirësohet duke i shfrytëzuar fjalorët ligjorë me qëllim të standardizimit të shprehjeve ligjore të cilat përdoren. Është shumë e paqartë nëse termi anglez për anëtarin e Kuvendit ndonjëherë përkthehet si anëtar, ndonjëherë si deputet, e kështu me rradhë. Aktualisht, Misioni i OSBE-së në Kosovë (Ekipi për përkrahje të qeverisjes qendrore) është duke punuar në një fjalor të tillë ligjor i cili mund të shfrytëzohet për t'i standardizuar shprehjet ligjore në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Në planin afatmesëm, IPVQ-të mund ta planifikojnë inkura-

jimin e të gjithë shërbyesve civil në mënyrë që ata të vijojnë kurse të gjuhës që ofrohen nga punëdhënësi: jo vetëm kurse të gjuhës serbe dhe angleze për shërbyesit civil shqiptarë, por edhe kurse të gjuhës shqipe për shërbyesit civil serbë. Një qëllim tjetër do të ishte minimizimi i nevojës për të ofruar përkthim në gjuhën angleze, pasi që kjo bën presion të panevojshëm te IPVQ-të përderisa nuk ka mjaft përkthyes për anglisht në dispozicion.

Kjo na sjellë deri te strategjia afatgjate që do të duhej ta kishte për qëllim ndërtimin e kapaciteteve të njësisve profesionale për përkthim ligjor në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe përbrenda IPVQ-ve. Si të trajnohen përkthyesit për përkthime ligjore në pajtim me standardet europiane? Deri më tani nuk ka ekzistuar një autoritet për certifikim në Kosovë që do të testonte dhe aprovonte shkathtësitë e përkthyesëve/interpretuesëve. Madje edhe në shoqëritë të cilat funksionojnë në masën më të madhe vetëm në një gjuhë, siç është Gjermania, ekzistojnë shkolla dhe fakultete univerzitare të cilat e mësojnë përkthimin si profesion. Ato ua japin studentëve diplomat nëse ata i kalojnë testet gjithëpërfshirëse. Është më se e qartë se Kosova do të përfitonte nga institucione të tilla. Themelimi i një instituti – p.sh. Instituti Kosovar për Përkthim dhe Interpretim – me detyrë që t'i ofrojë kurset për përkthyesit profesional dhe për shërbyesit civil, është hapi i vetëm logjik dhe është padyshim i domosdoshëm kur kemi parasysh kushtet. Kjo edhe për arsye se nevoja për përkthim ligjor profesional do të jetë edhe më e rëndësishme kur IPVQ-të të obligohen edhe zyrtarisht që ta miratojnë *aquis communi-*

*taire european*<sup>3</sup>... Një institut i tillë do të shërbente gjithashtu edhe si autoritet certifikimi për përkthyesit dhe interpretuesit në pajtim me standardet ndërkombëtare – jo vetëm për institucionet publike por edhe për sektorin privat dhe investitorët e huaj.

Përveç funksionit themelor të trajnimit dhe certifikimit të përkthyesëve dhe interpretëve profesionalë, një institut i tillë do të kishte edhe qëllime tjera të dobishme: do të mund të ofronte përkthim të cilësisë së lartë drejtëpërsëdrejti për IPVQ-të, si edhe ekspertiza kur ka dallime në ligjin e aplikueshëm ndërmjet dy versioneve gjuhësore.

Ideja për institutin e gjuhëve është paraqitur gjatë vitit 2004 dhe donatorët do të ishin të gatshëm që t'i përkrahnin IPVQ-të nëse kjo ide do të aprovohej. Pa dyshim, nëse vërtetë do të themelohej Instituti i Përkthimit dhe Interpretimit, përgatitjet do të duhej të fillonin sa më parë që është e

mundur. Kjo për arsye se nevojitet shumë kohë që të trajnohet një gjeneratë e përkthyesëve/interpretëve profesionalë, kohë kjo e cila matet me vite, posaçërisht kur kemi të bëjmë me përkthimin ligjor.

Së fundmi, këto opservime për mangësitë ekzistuese në cilësinë e përkthimeve janë bërë gjatë aktiviteteve të ndryshme përkrahëse dhe konsultimeve me Kuvendin e Kosovës, por nuk kanë aspirata që ta reflektojnë në tërësi gjendjen e përgjithshme në IPVQ. Megjithatë, problemi duket se është akut sikurse që mund ta ilustrojë edhe shembulli i fundit: si duket projektligji mbi inspektoratin e punës në versionin në gjuhën shqipe i referohej më shumë insekteve punuese se sa inspektorëve të punës. Ndoshta ky gabim është korrigjuar me ndonjë amendament tjetër gjuhësor në Kuvend ose ndoshta përsëri është gabuar gjatë përkthimit dhe për këtë arsye ende i sfidon institucionet e ngarkuara me implementimin e tij.



Shërbimi i OMik-ut për përkthim gjatë punës.

<sup>3</sup> Në Gjermani vlerësohet se 50-70% e legjislacionit nuk përpilohet më në Berlin, por në Bruksel

# Vlerësim i implementimit të politikës gjuhësore në praktikat komunale

Edhe pse ekziston një përparim i dukshëm nëpër komuna sa i përket përdorimit të standardeve zyrtare të përdorimit të gjuhës, bashkësitë etnike të Kosovës ende nuk mundën plotësisht të i gëzojnë të drejtat e tyre gjuhësore të garantuara me ligj. Arsyet kryesore për problemet ekzistuese janë kuptimi jo-uniform i ligjit të zbatueshëm nga ana e autoriteteve komunale, zyrat e përkthimit me numer jo të mjaftueshëm të punëtorëve, mungesa e përkthyesëve të kualifikuar, mundësitë e pamjaftueshme teknike dhe vullneti pamjaftueshëm politik i zyrtarëve komunal. Ndërmarrja e disa hapave në të njëjtën kohë nga ana e autoriteteve komunale, nga bashkësitë që i prekë ky problem dhe nga ana e bashkësisë ndërkombëtare mundën të prekin këtë problem në mënyrë direkte.

Për fillim, qeveritë komunale duhet të fillojnë të zbatojnë plotësisht ligjin ekzistues si dhe të planifikojnë me kohë në mënyrë që të sigurojnë pajtueshmërinë afatgjate me standardet gjuhësore. Bashkësitë gjithashtu duhet të jenë aktive dhe të i shfrytëzojnë mjetete ekzistues ligjore dhe institucionale në mbrojtjen e të drejtave të tyre në përdorimin e gjuhës. Për më tepër, bashkësia ndërkombëtare duhet të përdorë ndikim e saj politik në rishikimin dhe insistimin në përmirësimin e zbatimit të standardeve gjuhësore të cilat njëherit janë edhe pjesë e Planit për Implementimin e Standardeve për Kosovën.

Përgatitur nga Anna Stoyanova, Zyra për Raportime dhe Analiza, Departamenti për Demokratizim

Ka pasur së voni një trend përmirësimi në implementimin e ligjit të aplikueshëm mbi gjuhët nga qeveritë komunale. Sidoqoftë, sipas rezultateve të një hulumtimi të bërë në nivel komunal në gusht 2004 nga Misioni i OSBE-së përmes Departamentit të tij për Demokratizim (DD), mbetet shumë për t'u bërë para se të raportohet se politikat gjuhësore implemtohen në mënyrë adekuate nga autoritetet komunale. Hulumtimi studioi implementimin e Seksionit 9 mbi gjuhët të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë për të vlerësuar gjendjen aktuale të implementimit të politikës gjuhësore në praktikat komunale

Rezultatet e hulumtimit, në masë të madhe mbështesin konkluzionet kryesisht kritike të Grupit Punues mbi Pajtueshmërinë e Standardeve Gjuhësore të periudhës janar-shkurt 2004.<sup>1</sup>

Në të njëjtën kohë, një zhvillim pozitiv i raportuar ka qenë shtimi relativ i përkushtimit të autoriteteve komunale për të implementuar kërkesat nga

Seksioni 9. Shumica e të metave të identifikuar kanë të bëjnë me problemet dhe vonesat e lëshimit në të njëjtën kohë të dokumenteve zyrtare në të gjitha gjuhët relevante dhe çështja e ndjeshme politike e shkrimit të shenjave zyrtare në të gjitha gjuhët e kërkuara. Arsyet për problemet ekzistuese përfshijnë një kombinim të sfidave teknike dhe politike. Vështirësitë që rezultojnë nga mjetet joadekuate teknike për të bërë përkthimet, zyrat e përkthimit me personel të pamjaftueshëm, mungesa e përkthyesve të kualifikuar dhe burimet e pakta financiare janë endemike. Për më tepër, kësaj mungese të burimeve i është bashkuar edhe mungesa e të kuptuarit nga zyrtarët komunalë të ligjit të aplikueshëm dhe mungesa e vullnetit të mjaftueshëm politik për t'i dhënë prioritet çështjes së të drejtave gjuhësore.

## I. Përmbledhje e situatës aktuale

Rezultatet e hulumtimit tregojnë një shkallë në rritje të pajtues-



Shenja zyrtare komunale në Kamenicë në tri gjuhët, të gjitha të shkruara drejt.

mërisë komunale me kërkesat e Seksionit 9 mbi gjuhët të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45. Vlerësimi i zyrtarëve për Demokratizim të Misionit të OSBE-së mbi implementimin e kërkesave gjuhësore ndryshon nga "shumë mirë" në "(pjesërisht) të kënaqshme" deri në të "pakënaqshme". Ajo çfarë është për optimizëm, është fakti që dy të tretat e komunave kanë

raportuar përkushtim ekzistues nga ana e autoriteteve komunale për të implementuar kërkesat gjuhësore.

Sidoqoftë, shpesh burim motivimi duket të jetë urgjenca për të plotësuar kërkesat nga Plani i Implementimit të Standardeve për Kosovën (PISK), duke e bërë të vështirë të vlerësohet shkalla e të kuptuarit nga zyrtarët të arsyeshmërisë që qën-

<sup>1</sup>) Grupi punues mbi Pajtueshmërinë e Standardeve Gjuhësore është themeluar më 15 janar 2004 dhe përfshinë përfaqësues nga OSBE, Zyra e UNMIK-ut për Çështjetë të Komuniteteve, Zyrën e UNMIK-ut për Kthim dhe Komunitete, Zyrën e Kryeministrit dhe Ministrinë e Shërbimeve Publike. Grupi punues shqyrtoi çështjen e mospajtueshmërisë nga ana e autoriteteve administrative të Kosovës në implementimin e standardeve gjuhësore. Grupi Punues erdhi në përfundim që "përdorimi i lirë i gjuhës dhe rrespekti për kërkesat ligjore mbi gjuhët është në rastin më të mirë pasiv dhe në atë më të keqin i injoruar". Pengesat teknike dhe mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare janë pengesa kronike të padiskutueshme. Sidoqoftë, pika kritike bllokuese u pa të jetë mungesa e përkushtimit të zyrtarëve ndaj një politike të vërtetë gjuhësore.

dron pas politikës gjuhësore. Në një numër rastesh vështirësitë teknike dhe pamjaftueshmëria e burimeve financiare dhe njerëzore kanë paraqitur një pengesë të madhe për pajtueshmërinë e suksesshme, përkundër vullnetit të zyrtarëve.

Në rastet tjera, derisa autoritetet lokale nuk kanë ndonjë vërejtje për kërkesat, nuk është ndërmarrë ndonjë veprim i duhur. Së fundi, në komunat aktualisht monoetnike apo në ato ku një apo dy komunitete etnike përbëjnë një shumicë dërrmuese, autoritetet komunale, siç raportohet, i shohin kërkesat gjuhësore si të imponuara artificialisht apo/dhe të panevojshme, mbi baza se kërkesat për një shërbim në gjuhë të tillë nuk ekziston dhe refuzojnë t'i implementojnë ato.

Një shikim nga afër i implementimit të nënpjesëve individuale të Seksionit 9 zbulon disa modele. Përderisa, gati të gjitha statutet e komunave përbajnë disa dispozita për përdorimin e gjuhës në pajtim me Seksionit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45<sup>2</sup>, pak nga ato janë "dispozita të qarta", siç kërkohet nga e njëjta pjesë. Efektivisht, në mungesë të direktivave të qarta, shumica e dispozitave nuk i adresohen çështjes së përdorimit të gjuhës në mënyrë adekuate.

Komunikimi gojor me zyrtarët komunalë nuk është raportuar të jetë problem, më së shumti nga shkakut se shumica e zyrtarëve komunal flasin edhe shqip edhe serbisht dhe kanë vullnet për të arritur komunikim efektiv. Në



*Shenjë rrugore në komunën multietnike të Prizrenit në shqip, serbisht dhe turqisht.*

të njëjtën kohë, duhet të pranohet se anëtarët e komuniteteve të tjera gjuhësore duhet të komunikojnë në gjuhët që për ta nuk janë amtare. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mbahen kryesisht në të dy gjuhët, në shqip dhe në serbisht siç kërkohet nga Rregullorja. Në përgjithësi është e garantuar që të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal plotësisht të kuptojnë punën e sesioneve. Sidoqoftë, publiku, nëse është prezent, duket të jetë i hendikepuar sepse në shumicën e rasteve mungon përkthimi. Mbledhjet e Komiteteve mbahen sipas principit të njëjtë të "komunikimit efektiv", në disa raste prap duke devijuar nga kërkesat ligjore.<sup>3</sup>

Situata e përkthimit simultan dhe shtypjes së dokumenteve në gjuhën shqipe dhe serbe, si dhe në gjuhën tjetër "kur ka nevojë" ndryshon. Shumë shpesh ka

vonesa të mëdha, përkthime të pakompletuara apo mbështetje në vetëiniciativë të komuniteteve në nevojë për t'iu afruar zyrtarëve të përkthimit. "Kur ka nevojë", në praktikë barazohet me "pas kërkesës", sidomos sa i përket komuniteteve joshqiptare dhe joserbe dhe ndonjëherë edhe kur ka të bëjë me përkthim në një prej gjuhëve të detyrueshme

Individualisht, çështja e implementimit të të drejtave gjuhësore lidhur me komunitetet joshqiptare dhe joserbe kërkon përkujdesje të veçantë. Rregullorja 2000/45 është shumë e paqartë për kërkesat për shërbime komunale gjuhësore për ato komunitete duke lënë kështu hapësirë për vendime arbitrare<sup>4</sup>. Si rezultat, këto komunitete rallë marrin shërbime sipas Seksionit 9.2 dhe 9.3 përveç në Prizren dhe ndonjëherë në Prishtinë. Arsyet e deklaruara më së shpeshti janë

që komuniteti gjuhësor në fjalë është i pakët në numër, që nuk ka ndonjë kërkesë të fuqishme apo që ata lehtë mund t'i adaptohen njëherë nga dy gjuhët zyrtare, që statutet e komunave nuk identifikojnë komunitetet gjuhësore për të cilat do të përdoshin këto dispozita dhe se ka mungesë të burimeve teknike dhe njerëzore.

Një çështje tjetër politikisht sensitive e mbetur pezull sipas Seksionit 9.4 të Rregullores 2000/45 i përket kërkesave që shenjat zyrtare që tregojnë apo përfshijnë emrat e qyteteve, fshatrave, udhëve, rrugëve apo vendeve të tjera publike duhet t'i japin ata emra në shqip dhe në serbisht si dhe në ato komuna ku jeton një komunitet gjuha e të cilit nuk është as shqipja as serbishtja ata emra poashtu duhet të ipen në gjuhën e atij komuniteti.

Tani për tani, shënjat për udhë, qytete, fshatra dhe rrugë rrallë apo në mënyrë jokonsistente janë dhënë në më shumë se një gjuhë duke pasur parasysh që fshatrat dhe rrugët rrallë kanë ndonjë shenjë. Për më tepër, në shenjat ekzistuese të qyteteve, versioni i dytë nuk është i shënuar mirë duke humbur qëllimin për të pasur dy versione në dy gjuhë.

Vandalizmi poashtu është i shpeshtë dhe në shumë raste njëri nga dy verzionet është gërritur apo shkarravitur.

Në përgjithësi, pajtueshmëria e kërkesat e Rregullores mbi shenjat zyrtare është më e ulëta në mikro nivel, sidomos sa i përket shenjave të rrugëve<sup>5</sup>.

<sup>2</sup>) Përjashtime në: Kaçanik, Malishevë, Gjilan

<sup>3</sup>) Me disa përjashtime, në mbledhjet e Komitetit për Komunitete dhe Komitetit për Ndërmjetësim gjithmonë ofrohet përkthimi. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Bordit të Drejtorëve kanë apo nuk kanë përkthim, varësisht nga përbërja etnike, por ndonjëherë në disadavantaz të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë të cilët nuk kanë mundësi të kuptojnë plotësisht çështjet që diskutohen dhe rrjedhën e sesionit

<sup>4</sup>) Rregullorja nuk qartëson se sa duhet të jetë numri i atij komuniteti dhe nuk emëron komunitetet për të cilat aplikohen dispozitat. Është shqetësuese që sa i përket atyre komuniteteve përkthimi në shqip i Seksionit 9.4 mbi shenjat zyrtare dhe shenjat zyrtare dhe shenjat publike specifikon një prag minimal prej 10% (një numër relativisht i madh), përderisa nuk janë përmendur kurrfarë numrash në versionet anglisht dhe shqip. [http://www.unmikonline.org/albanian/regulations/2000/ra2000\\_45.htm](http://www.unmikonline.org/albanian/regulations/2000/ra2000_45.htm)

<sup>5</sup>) Është shkaktuar huti e madhe nga parregullsitë dhe mospërputhjet në emërimin e rrugëve. Shumë shpesh emrat e rrugëve janë vetëm në një gjuhë apo në tri versione - dy versione që nga viti 1999 dhe një nga viti 1991 janë në përdorim në mungesë të një udhëzimi të qartë administrativ. Në anën tjetër, emrat e rrugëve në Prishtinë janë të shkruar në shqip dhe anglisht. Si rezultat, ofrimi i shërbimeve publike dhe postare është shumë i komplikuar, me një efekt shumë të madh në jetën e përditshme të njerëzve të Kosovës.

Situata edhe më tepër është komplikuar me trendet e vazhdueshme të "shqiptarizimit" joformal të emrave zyrtar dhe në disa praktika administrative. Tendenca për të riemëruar qytetet, fshatrat dhe vendbanimet po bëhet e dukshme shumë shpejt. Shembujt përfshijnë: Dardanë (Kamenicë), Besianë (Podujevë), Drenas (Glogoc), Albanik (Leposaviq), Kastriot (Obiliq), Therandë (Suharekë), Sharr (Dragash), Artanë (Novobërdë) dhe Burim (Istog). Përderisa emrat zyrtarë janë të definuar qartë – së fundi edhe përmes Udhëzimit Administrative të UNMIK-ut 2004/23<sup>6</sup> – ata emra alternativë po marrin legjitimitet duke u përdorur gjerësisht në media, transport publik dhe në sferat tjera të jetës së përditshme. Përveç se janë joligjore, këto praktika shkaktojnë huti dhe thellojnë polarizimin.

## II. Shkaqet

Përderisa shkaqet për një gjendje të tillë janë të njëjta për të gjitha komunat, në mënyrë të pashmangshme një faktor me shumë ndikim që duhet të kihet parasysh është përbërja e ndryshme etnike e komunave.

Dy grupe çështjes ngriten bazuar në profiling etnik të komunës: a) nëse komuna është monoetnike apo multietnike dhe si ndikon kjo në mënyrë specifike në nevojën/kërkesën për shërbime përkthimi<sup>7</sup> dhe b) nëse komunitetet e prekura janë dy grupet më të mëdha në Kosovë, komuniteti shqiptar dhe ai serb, tek të cilët aplikohen kërkesat e qarta ligjore, apo komuniteteve të vogla të cilave u adresohet vetëm përmes dispozitave shumë të paqarta ligjore.

Logjikisht, shkalla e implementimit të politikës gjuhësore nga komunat ndryshon shumë, varësisht se sa i madh është numri i komunitetit gjuhësorë. Në komunat thellësisht të dominuara nga një grup gjuhësor sikurse Malisheva, Deçani, Gjilani, Leposaviqi apo Zveçani, siç raportohet, autoritetet nuk shohin ndonjë nevojë për të implementuar aspak kërkesat gjuhësore. Për dallim, Novobërda, përbërja etnike e së cilës është gati e balancuar 50/50 në mes të shqiptarëve dhe serbëve, implementimi është vlerësuar si më i larti. Dhe në fund, në komunën multietnike të Prizrenit ku komunitetet gjuhësore turke, shqiptare, serbe, boshnjake dhe rome bashkëekzistojnë, pajtueshmëria në hulumtim vlerësohet "e kënaqshme deri në një shkallë"

Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, shkaktarët e problemeve ekzistuese në implementimin e politikës gjuhësore mund të grupohen në tre kategori kryesore.

*Ligji i aplikueshëm nuk kuptohet në mënyrë uniforme nga autoritetet komunale gjatë implementimit të tij.*

Ligji i aplikueshëm dhe sidomos Seksioni 9 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 interpretohet dhe aplikohet në mënyrë të ndryshme nga komunat e ndryshme.

Një arsye është formulimi i paqartë i këtij seksioni lidhur me komunitetet joshqiptare dhe joserbe, pasi që asnjëherë nuk është cekur madhësia apo gjuha e komunitetit në fjalë.

Si rezultat, implementimi tani kërkon maturi dhe të gjykuar solid nga ana e autoriteteve

komunale. Mbi të gjitha, kërkon të kuptuarit e arsyes pas dispozitave ligjore. Sidoqoftë, në praktikë jo të gjitha komunat kanë demonstruar një mirëkuptim të tillë. Disa komuna haptas kanë deklaruar që e shohin politikën gjuhësore si të panevojshme. Shumica dërmuese nuk ka futur dispozita të detajuara në statutet e tyre komunale që do të dëshmonin të kuptuarit e ligjit dhe vullnetin politik për t'a implementuar atë. Sikurse u tha edhe më lartë, disa kanë treguar devotshmëri vetëm në kontekst të përmbushjes së PISK-ut lokal duke e pranuar mosbesimin në nevojën për të pasur shërbime gjuhësore të rregulluara me ligj.

*Zyrat për përkthim me personel të pamjaftueshëm, mungesa e personelit të kualifikuar dhe mundësitë joadekuate teknike*

Shumica e komunave nuk kanë kushte për të ofruar shërbime përkthimi për shkak të kapaciteteve teknike dhe humane jo të mjaftueshme<sup>8</sup>.

Zyrat komunale për përkthim edhe kur ekzistojnë kanë personel të pamjaftueshëm apo personel të pakualifikuar. Një prej arsyeve të dhëna është se pagat janë shumë të ulëta për të tërhequr aplikantë të arsimuar por edhe se përkthyesit profesional nuk angazhohen mbi baza se shërbyesit civil komunal flasin dy gjuhë. Për më tepër, shumica dërmuese e komunave kanë mungesë të pajimeve për të ofruar përkthim simultan. Sido që të jetë, ndonjëherë pajimet ekzistojnë, por nuk përdoren.

*Nevoja për vullnet të fuqishëm politik dhe përkushtim të sinqertë të demonstruar.*

Përderisa shtimi i raportuar i vullnetit të zyrtarëve për të implementuar politikën gjuhësore është inkurajues, është evidente që një masë e madhe e problemeve të tanishme mund të zgjidhen nëse do të ekzistonte vullneti i mjaftueshëm politik. Çështja është më e dukshme sa i përket shkruarjes së shen-



*Shembull i përdorimit publik të emrave jozyrtarë të qyteteve. Shenja e shkruar drejtë është: Obiliq/Obilić në vend të Kastriot/ Obilić*

<sup>6</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 2003/23 mbi zbatimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut Nr 2000/43 për numrin, emrat dhe kufinj administrativë të komunave, UNMIK/DIR/2004/23 8 shtator 2004

<sup>7</sup> Pasi që shumica e komunave kërkojnë nga komuniteti në nevojë të marrë iniciativën për të kërkuar shërbime përkthimi, një çështje esenciale mbetet nëse pjesëtarët e komunitetit joshumicë e realizojnë të drejtën e tyre për të kërkuar shërbime në gjuhën e tyre, sipas Seksionit 9

<sup>8</sup> Deri në një shkallë të caktuar, probleme të tilla janë raportuar në së paku 20 nga 30 komunat.




jave zyrtare në të gjitha gjuhët e kërkuara nga ligji. Me kërkesat e qarta ligjore të tanishme, implementimi tyre varet tërësisht nga autoritetet komunale. Për më tepër, ato kuvende komunale që nuk e kanë bërë një gjë të tillë, mund t'i përmirësojnë dispozitat mbi përdorimin e gjuhës në statutet e tyre.

Komunat poashtu mund të përpiqen të përmirësojnë kapacitetet e tyre duke angazhuar përkthyes të kualifikuar, blerë pajisje teknike apo duke i shfrytëzuar në mënyrë efikase, siç raportohet, ato të lëna pas dore. Autoritetet komunale pa shpenzime të mëdha mund të përmirësojnë punën e zyrave komunale të përkthimit duke u dërguar atyre dokumentacionin e nevojshëm me kohë dhe duke bërë kontrollin e kualitetit për të tejkaluar vonesat ekzistuese dhe shpesh përkthimet jokomplete.

Si përfundim, ka akoma nevojë për të parë një përkushtim të sinqertë të demonstruar nga autoritetet komunale përmes veprimeve të devotshme konstruktive.

### III. Shikimi drejt ardhmërisë: Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i implementimit të politikës gjuhësore - Përfundimet

Gjendja e tanishme e implementimit të politikës gjuhësore në Kosovo nxjerr në pah disa çështje me shqetësim. Përderisa është arritur njëfarë përparimi në implementim nga komunat, qëndrueshmëria nuk është e siguruar. Njëra çështje është largimi i gjeneratës së vjetër të shërbyesve civil, shumica e të cilëve flasin dy gjuhë, duke ofruar kështu shërbime gjuhësore pa ndonjë përpjekje të veçantë nga ana e autoriteteve qendrore



Qendra shëndetësore në Kamenicë

apo komunale të Kosovës. Për më tepër, ka një varshmëri në disa komuna nga marrja e burimeve të UNMIK-ut për të ofruar përkthimin e nevojshëm. Përveç kësaj, ka një rrezik që momenti i pajtueshmërisë së shtuar komunale me standardet zyrtare mbi gjuhët do të jetë jetëshkurtër, pasi që pajtueshmëria shihet ekskluzivisht në kontekst të përmbushjes së PISK-ut komunal. Gjithashtu, sikur u përkthet, ka shumë probleme të implementimit të standardeve gjuhësore që mund por nuk janë zgjidhur dhe të cilave autoritetet komunale duhet t'u qasen si çështje prioritare.

Së pari gjëja më e rëndësishme është që të gjitha komunat të fillojnë të aplikojnë në tërësi ligjin ekzistues. Përderisa Rregullorja është e formuluar në mënyrë të paqartë sa i përket komuniteteve më të vogla të Kosovës, teksti i saj është i qartë kur i referohet dy komuniteteve më të mëdha. Sa i përket komuniteteve më të vogla, ku Seksioni 9 kërkon një diskrecion nga autoritetet lokale, duhet një qasje e dyfishtë. Në nivelin lokal duhet të sigurohet që zyr-

tarët komunal i kuptojnë arsyet prapa ligjit të aplikueshëm që të mund të përfshijnë dispozita të detajuara në statutet e komunave të tyre, sipas kërkesave më të përgjithshme të Seksioni 9. Në të njëjtën kohë, në nivel qendror duhet të shqyrtohet hartimi i një ligji mbi përdorimin e gjuhës në Kosovë që do të unifikonte dhe sqaronte kornizën ligjore komplekse të tanishme<sup>9</sup>.

E dyta, komunat duhet të sigurojnë burime dhe të planifikojnë me kohë për të siguruar një pajtueshmëri me standardet gjuhësore. Autoritetet lokale duhet të marrin përkrahje financiare shtesë për të forcuar kapacitetet e tyre për përkthim - blerja e pajimeve për përkthim dhe angazhimi i stafit shtesë - nëse është e nevojshme. Për shërbyesit e rinjë civil, të cilët nuk flasin më shumë se një gjuhë, komunat duhet të marrin parasysh organizimin e kurseve për gjuhë.

Pajtueshmëria komunale me politikën zyrtare gjuhësore është parakusht për përmbushjen e të drejtave gjuhësore të komunitetit në Kosovë. Në të njëjtën kohë, të gjitha komunitetet etnike/gjuhë-

sore të Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar mund dhe duhet të marrin pjesë në mënyrë konstruktive në këtë proces.

Këto komunitete duhet të jenë më aktive dhe të përdorin mjetet ligjore dhe institucionale për të kërkuar të drejtat e tyre. Mbi të gjitha, anëtarët e komuniteteve mund t'i drejtohen komiteteve të detyrueshme antidiskriminatore komunale për Komunitete dhe Ndërmjetësim, nëse ata ndjehen se të drejtat e tyre janë të shkelura. Në mënyrë alternative, ata poashtu mund të kërkojnë të drejtat e tyre ligjore sipas Ligjit kundër Diskriminimit të miratuar rishtazi<sup>10</sup>.

Sidoqoftë, për t'i përdorur në mënyrë efektive këta mekanizma, anëtarët e komuniteteve duhet të jenë së pari të vetëdijshëm për të drejtat e tyre. Organizatat ndërkombëtare mund të ndihmojnë në zhvillimin dhe fuqizimin e fushatave për ngritjen e vetëdijes për anëtarët e komuniteteve sikurse edhe të përgatisin aktivitetet për të përmirësuar të kuptuarit nga ana e zyrtarëve komunal arsyet prapa ligjit të aplikueshëm. Për më tepër, komuniteti ndërkombëtar duhet të përdorë ndikimin e tij politik për të rishqyrtuar dhe të insistojë në përmirësimin e aplikimit të standardeve gjuhësore, të cilat janë pjesë e PISK.

Si përfundim, përderisa ka pasur një përparim në praktikat komunale në lidhje me pajtueshmërinë me standardet gjuhësore, komunitetet e Kosovës nuk kanë mundësi që të ushtrojnë në tërësi të drejtat e tyre ligjore. Pra momenti i tanishëm konstruktiv nuk duhet të humbë, por duhet të shtohen përpjekjet e shumëanëshme për të zgjidhur problemet ekzistuese sa më parë që të jetë e mundur.

<sup>9</sup> Qeveria ka përfshirë Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhës në strategjinë e saj ligjore për vitin 2005

<sup>10</sup> Dekretuar nga PSPP më 20 gusht 2004, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/23

# Arsimimi multietnik<sup>1</sup>

Arsimimi në gjuhën amtare është shumë i rëndësishëm për një shoqëri paqësore, përparimtare dhe multietnike. Një kornizë ligjore që i garanton çdo fëmijë qasje në arsim është direkt e aplikueshme në Kosovë.

Në Kosovë ekziston dhe është e gatshme për zbatim të drejtpërdrejt korniza ligjore që i garanton secilit fëmijë të shkollohet në gjuhën amtare. Fatkeqësisht, zbatimimi i saj ka qenë joadekuat dhe deri më tash ka munguar një çasje gjithëpërfshirëse nga ana e IPVQ drejt arsimimit të komuniteteve pakicë. Edhe pse ekzistojnë shembuj pozitiv të përfshirjes së fëmijëve të pakicave në procesin e arsimit, këto raste janë sporadike dhe të rralla. Bashkësitë etnike që kanë pësuar më së shumti në këtë drejtim janë bashkësitë e vogla të pakicave e posaçërisht ato që me aftësi të kufizuara. E drejta për të u shkolluar në gjuhën amtare është e drejtë universale dhe IPVQ janë përgjegjëse që kjo t'u sigurohet pjestarëve të bashkësive të pakicave në mënyrë efektive.

Radoslaw Rzehak, Këshilltar i Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe Jodiskriminim, Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Çelës për një shoqëri të lumtur, paqësore, tolerante dhe të pasur është arsimimi i gjeneratës së saj më të re. Si rezultat, mund të mendojmë që çelës për një shoqëri të lumtur, paqësore, tolerante dhe të pasur është arsimimi multietnik.

Shtrohet pyetja, çfarë do të thotë arsimimi multietnik nën dritën e standardeve ndërkombëtare dhe praktikës së përgjithshme në Kosovë?

Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Qytetare dhe Politike<sup>2</sup>, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijut<sup>3</sup> apo Ligji mbi Arsimimin e Lartë<sup>4</sup> në Kosovë qartazi thonë që asnjë fëmijë nuk do t'i mohohet e drejta për arsimim. Nuk ka nevojë të argumentohet që vetëm arsimimi në gjuhën amtare, duke rrespektuar kulturën e vet, mund të krijojë një ambient që fëmijë të gëzojnë të drejtat e veta themelore të njeriut. Situata kur një fëmijë shkon në shkollë ku ai apo ajo merr mësimet në një gjuhë të pakuptueshme për të dhe për një kulturë apo të histori të huaj duket të jetë e ankthshme. Për fat të mirë, një rast i tillë është i ndaluar me ligjin kosovar dhe ndërkombëtar. Ekziston korniza ligjore që garanton qasjen në



*Shenja për shkollën në komunën e Gjilanit, vetëm në shqip.*

arsim për të gjithë fëmijët në Kosovë. Për fat të keq, implementimi i këtyre dispozitivave ligjore të avansuara ka qenë jo i duhur, duke e bërë në këtë mënyrë jetën e një fëmijë në Kosovë një ankth.

## Realiteti kosovar

Është bërë shumë për të siguruar qasjen e fëmijëve të Kosovës në arsim, por shumë mbetet për t'u bërë për të garantuar arsim efektiv për të gjithë. Ka shumë shembuj pozitiv për përfshirjen e fëmijëve pakicë në sistemin ekzistues arsimor. Për

shembull, fëmijët turq mund t'i marrin mësimet në gjuhën turke në Prishtinë, Gjilan dhe Prizren. Nxënësit boshnjakë janë të regjistruar në arsim fillor në Prishtinë dhe ata romë kanë orë mësimi në gjuhën romë në arsimin parashkollor dhe fillor në Gjilan.

Këto janë iniciativa të nevojshme dhe për t'u lavdëruar që provojnë se arsimimi multietnik në Kosovë është i mundshëm.

Për fat të keq, këta shembuj pozitiv janë sporadik dhe të rallë. Në anën tjetër, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

(MASHT) dhe komuna e Dragashit akoma nuk e kanë zgjidhur situatën komplekse të arsimimit të fëmijëve goran, të cilët për dy vite presin për një kompromis nëse ata duhet të ndjekin planprogramin shqiptar për klasën e nëntë apo atë serb të klasës së tetë. Vonesa për t'iu qasur në mënyrë të duhur kësaj çështje ka krijuar më tepër stres për nxënësit dhe ka ndikuar në qasjen e tyre në shkollim të mesëm.

Fëmijët romë nga Gjilani kanë vështirësi të ngjajshme pasi që kanë problem me qasjen në arsimin e mesëm për shkak të mungesës së transportit të sigurt dhe të regullt për në shkollat që gjenden në enklavat serbe në afërsi të qytetit të Gjilanit. Misioni i OSBE-së në Kosovë vazhdon të marrë informacione mbi frikësimin e nxënësve ashkali në shkolla për shkak të origjinës së tyre etnike që është në kundërshtim me deklaratat e zyrtarëve të qeverisë që fëmijët ashkali janë plotësisht të integruar në sistemin arsimor të Kosovës duke qenë gjuha shqipe gjuhë e tyre amtare. Integrimi nuk do të thotë që fëmijët të kuptojnë gjuhën në të cilën u ipen mësimet, por do të thotë poashtu

<sup>1</sup> Për nevojat e këtij artikulli, me fjalët gjuhë minoritare autori kupton gjuhët e folura nga komunitetet që jetojnë në territorin e Kosovës, ndryshe nga gjuhët e njohura zyrtare siç janë: shqipja, serbishtja dhe anglishtja. Kështu pra, komunitetet pakicë të cilave u referohet në artikull janë: turqit, ashkallitë, boshnjakët, kroatët, egjiptasit, goranët dhe romët.

<sup>2</sup> <http://www.ohchr.org/english/law/ccpr-one.htm>

<sup>3</sup> <http://www.ohchr.org/english/law/>

<sup>4</sup> [http://www.unmikonline.org/regulations/index\\_reg\\_2002.htm](http://www.unmikonline.org/regulations/index_reg_2002.htm)

që ata të ndjehen të sigurtë dhe këndshëm gjatë mësimeve.

Gjithashtu, ka mangësi të shumta sa i përket qasjes në arsim të fëmijëve minoritarë me aftësi të kufizuara. Është vështirë të identifikohet ndonjë institucion arsimor që mund t'u ofrojë arsimim në gjuhën e tyre fëmijëve minoritarë me aftësi të kufizuara. Ata fëmijë, të privuar nga e drejta e tyre për arsimim, mbesin në shtëpi duke e ditur që ardhmëria e tyre është baraz me frikën nga e panjohura.

MASHT-i dhe komunat jo vetëm që nuk i qasen këtij problemi, por nuk kanë as informata të besueshme mbi numrin e këtyre fëmijëve apo nevojat e tyre.

Këta janë vetëm disa shembuj të një mungesë të qasjes gjithëpërfshirëse nga ana e IPVQ të Kosovës sa i përket arsimimit të komuniteteve pakicë. As MASHT e as autoritetet komunale për arsim nuk kanë një sistem për t'u përgjigjur shpejtë nevojave të këtyre komuniteteve. Për të treguar që këto komunitete janë njësoj të rëndësishme për institucionet publike, MASHT dhe komunat duhet të punojnë për t'iu qasur problemeve të arsimit të komuniteteve pakicë në një mënyrë të shpejtë dhe efektive. Me "mënyrë efektive" kuptohet që komunitetet vetë duhet të jenë më aktive dhe të marrin hapa për të gjetur zgjidhjet më të mira për problemet ekzistuese.

Është me rëndësi të kihet parasysh që shumica e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë janë në të njëjtën kohë personat më të rrezikuar në Kosovë. Për këtë arsye Qeveria duhet t'i kushtojë atyre vëmendje të posaçme duke

marrë një seri masash pozitive për të krijuar kushte të duhura të cilat do t'u mundësonin për të zhvilluar dhe në të njëjtën kohë bashkëjetesë paqësore me të gjitha komunitetet tjera në Kosovë. Masat afirmative të karakterit të përgjithshëm që u adresohen komuniteteve pakicë, duhet të përshtatshëm masa specifike që i adresohen grave minoritare dhe njerëzve me aftësi të kufizuara të cilët ballafaqohen me rrezikun e të ashtuquajturit "diskriminim i dyfishtë": duke qenë pjesëtarë i komunitetit pakicë dhe femër apo person me aftësi të kufizuara në të njëjtën kohë.

### Standardet themelore, ligji i aplikueshëm dhe rekomandimet

Vjeshtën e kaluar, UNMIK-u dhe IPVQ nënshkruar një marrëveshje me Këshillin e Evropës (KE) mbi masat teknike lidhur me implementimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKMP)<sup>5</sup>. Përveç tjerash, kjo ka të bëjë me monitorimin nga KE të implementimit të KKMP në Kosovë dhe se UNMIK-u do të dorëzojë raportin mbi implementimin e KKMP.

Pasi raporti ka karakter publik, do të tërheqë vëmendjen ndërkombëtare mbi vështirësitë e arsimit të minoriteteve në Kosovë. Si rezultat, problemet e arsimit në Kosovë do të bëhen një çështje më e madhe shqetësimi. Duke pasur parasysh që KKMP i kushton shumë nga nenet e saj mbrojtjes së të drejtës për të përdorur gjuhët e pakicave dhe i kushton vëmendje të veçantë të drejtës për të mësuar gjuhën

e vetë minoritare dhe të marrin mësime në të njëjtën gjuhën, njerëzit e Kosovës duhet të përcjellin me kujdes këtë hulumtim dhe raportim. Gjithashtu është me rëndësi të thuhet që zhvillimi i kulturës, identitetit, gjuhës dhe trashëgimisë kulturore të komuniteteve minoritare është i garantuar sipas KKMP. Palët të cilat kanë obligim ligjor të vëzhgojnë KKMP, d.m.th. UNMIK-u dhe IPVQ janë përgjegjëse për ndërmarrjen e hapave të duhur për të përmbushin dispozitat e KKMP dhe të raportojnë mbi implementimin e saj.

Ngjajshëm, Deklarata Evropiane Për Gjuhët Regjionale dhe Minoritare<sup>6</sup>, një dokument i rëndësishëm i KE i cili është i aplikueshëm në Kosovë, përcakton që autoritetet, sa i përket gjuhëve minoritare, duhet t'i bazojnë politikën, legjislacionin dhe praktikën e tyre në principin e njohjes së gjuhëve minoritare si një shprehje e pasurisë kulturore. Principet tjera të Deklaratës janë: nevoja për një veprim të vendosur për të promovuar gjuhët minoritare, për t'i mbrojtur ato dhe lehtësimi apo/edhe nxitja për t'i përdorur gjuhët minoritare në të folur dhe të shkruar në jetën publike dhe private. Deklarata më tutje përfshin një nen mbi krijimin e formave dhe mjeteve të përshtatshme për mësimin dhe studimin e gjuhëve minoritare në të gjitha shtetet dhe përmban një dispozitë për krijimin e hapsirës që do t'u mundësojë atyre që nuk e folin gjuhën minoritare, por që jetojnë në një zonë ku ajo përdoret, ta mësojnë atë nëse kanë dëshirë. Më në fund, Deklarata nënvizon që autoritetet do të ofrojnë

së paku një pjesë thelbësore të arsimit parashkollor, fillor, të mesëm, teknik, profesional dhe bile edhe atij të lartë në gjuhët e rëndësishme minoritare.

Për më tepër, ka shumë instrumente tjera ligjore ndërkombëtare dhe lokale që shprehin në mënyrë të qartë nevojën për mbrojtjen e të drejtës së komuniteteve minoritare të mësojnë dhe të marrin mësime në gjuhën e tyre amtare. Dy nga ato me rëndësi të madhe gjenden në dispozitat e Kornizës Kushtetuese<sup>7</sup> apo të Ligjit për Arsim në Kosovë. Poashtu ka dy dokumente të OSBE-së që i adresohen kësaj çështje në veçanti, pasi arsimimi i pakicave konsiderohet me një rëndësi të madhe për OSBE-në.

Së pari, Dokumenti i Mbledhjes së Kopenhagës<sup>8</sup> të Konferencës mbi Dimensionin Human të KSBE<sup>9</sup> në mënyrë të qartë konfirmoi që autoritetet duhet të mbrojnë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të pakicave kombëtare dhe të krijojnë kushte për përparimin e atij identiteti.

Së dyti, Rekomandimet e Hagës<sup>10</sup> Lidhur me të Drejtën në Arsim të Pakicave Kombëtare, tentuan të sqarojnë përmbajtjen e të drejtave për arsimim minoritar. Këto Rekomandime, të shkruara nën përkujdesjen e Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare, thonë që "e drejta e personave që i përkasin një pakice kombëtare për të ruajtur identitetin e tyre mund të realizohet në tërësi nëse marrin njohuri të duhura të gjuhës së tyre amtare gjatë procesit arsimor". Ky është një obligim themelor

<sup>5</sup> [http://www.coe.int/T/E/human\\_rights/minorities/](http://www.coe.int/T/E/human_rights/minorities/)

<sup>6</sup> <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/cadreprincipal.htm>

<sup>7</sup> <http://www.unmikonline.org/regulations/2001/reg09-01.htm>

<sup>8</sup> <http://www.osce.org/docs/english/1990-1999/hd/cope90e.htm>

<sup>9</sup> Emri zyrtar i OSBE-së para vitit 1995 ka qenë Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE).

<sup>10</sup> <http://www.osce.org/hcnm/documents/recommendations/>

që i adresohet autoriteteve. Sidoqoftë, pashtu është thënë që personat që i përkasin një pakice kombëtare kanë një përgjegjësi të integrohen në shoqërinë më të gjerë kombëtare përmes mësimin të duhur të gjuhës së shumicës. Do të thotë që anëtarët e komuniteteve pakicë kanë të drejtën në arsim në gjuhë tyre, po poashtu ata kanë përgjegjësinë për të mësuar gjuhën e komunitetit shumicë e cila është një kusht pa të cilin nuk mund të integrohen në komunitetin shumicë. Për atë arsye, udhëzimet për nxënësit minoritare për të mësuar gjuhën shqipe, të cilat ka qenë dashur të përgatiten në dhjetor 2003, sipas Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, duhet të përpilohen sa më shpejtë që është e mundur.

Nxitja e studentëve shqiptarë për të mësuar gjuhët e pakicave që jetojnë në Kosovë në mënyrë të rëndësishme do të kontribonte promovimit të tolerancës dhe zhvillimit të multikulturalizmit në Kosovë. Iniciativa e fundit e nxënësve shqiptarë dhe serbë të fshatit Bablak për t'i mësuar gjuhën njëri tjetrit demonstroi që ajo që dukej e pamundshme është e vërtetë dhe e realizueshme. Fshatarët thjeshtë u pajtuan që nxënësit serbë të kenë një herë në javë një orë shtesë të gjuhës shqipe dhe nxënësit shqiptarë një orë të gjuhës serbe. Pse të mos shtrihet kjo praktikë e mirë përtëj dy gjuhëve zyrtare, drejt gjuhëve të pakicave tjera që jetojnë në Kosovë?

Është me rëndësi të kihet në mend që autoritetet arsimore janë përgjegjëse për krijimin e kushteve të duhura për t'u mundësuar studentët minoritarë të mësojnë gjuhën dhe kulturën e shumicës në një mënyrë efektive, jodiskriminatore dhe të sigurtë. Kjo do të thotë, për shembull, të përfshihet një dispozitë

që gjuha e shumicës do të ishte e preferueshme të mësohet nga mësuesit që flasin të dy gjuhët të cilët kuptojnë mirë prapavijën kulturore dhe gjuhësore të fëmijëve.

Kjo na kthen te çështja e mungesës dhe e nevojës urgjente për një planprogram të unifikuar në Kosovë i cili do të përfshinte mësimet për historinë, kulturën dhe traditën e minoriteteve. Është shumë me rëndësi që përmblajtja e planprogramit lidhur me pakicat të përgatitet me një pjesëmarrje aktive të përfaqësuesve kompetent të pakicave.

### Universaliteti i të Drejtave Arsimore të Pakicave

E drejta për të mësuar dhe për të marrur mësim në gjuhën amtare nuk është vetëm koncept evropian por edhe universal. Për shembull, Konventa e UNESCO-s kundër Diskriminimit në Arsim<sup>11</sup> përforcon nevojën për njohje të së drejtës së pjesëtarëve të pakicave kombëtare për të përdorur apo mësuar gjuhën e tyre. Poashtu, Deklarata e KB-ve mbi të Drejtat e Personave që i Përkasin Pakicave Kombëtare, Etnike dhe Gjuhësore<sup>12</sup> kërkon që qeveritë të marrin masa për të krijuar kushte të favorshme, për të ju mundësuar personave që i përkasin pakicave të shprehin karakteristikat e tyre dhe të zhvillojnë kulturën, gjuhën, religjion, traditat dhe zakonet e tyre. Përveç kësaj, siguron që personat që i përkasin pakicave të kenë mundësi të barabarta për të mësuar gjuhën e tyre amtare apo t'u ofrohen mësim në gjuhën e tyre amtare. Autoritetet duhet të marrin masa përkatëse për të promovuar njohuritë mbi historinë, traditat, gjuhën dhe kulturën e pakicave që ekzistojnë në territorin që ato e qeverisin.

E gjitha që u tha më lartë konfirmon nevojën për mbrojtjen dhe implementimin e të drejtës për të mësuar gjuhën dhe për t'u ofruar mësim në gjuhën e pakicave është përgjegjësi univerzale, evropiane dhe në të njëjtën kohë kosovare.

### Të ecet përpara

Arsimimi në gjuhën amtare nuk është një privilegj por një e drejtë e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë. Veç kësaj, qeveritë janë përgjegjëse për të siguruar që kjo e drejtë mund të ushtrohet në mënyrë efektive nga njerëzit që jetojnë në territorin nën autoritetin e tyre. Kjo nuk mund të interpretohet në asnjë mënyrë si një përpjekje për të ndarë komunitetet e ndryshme. Në të kundërtën, avokon për të bashkuar komunitetet e ndryshme duke krijuar mundësi të barabarta për të gjithë. Ndiemo për të krijuar një vend ku të gjitha kulturat janë të rrespektuara dhe të mbrojtura në mënyrë të barabartë, për të krijuar një situatë në të cilën të gjithë njerëzit janë plotësisht të rrespektuar dhe të mbrojtur, për të krijuar një situatë ku të gjithë janë plotësisht të rrespektuar dhe si rezultat ka një integrim të plotë të të gjithë etnive duke e bërë Kosovën një vend më të mirë për të jetuar.

Implementimi i të drejtave themelore mund ta bëjë Kosovën një vend më të mirë për të jetuar për secilin banorë. Diversiteti i komuniteteve që jetojnë në Kosovë – kulturat e ndryshme, të folurit e gjuhëve të ndryshme – e bënë këtë vend me të vërtetë shumë sfidues për t'a qeverisur, por në të njëjtën kohë e bën Kosovën të pasur dhe të veçantë në krahasim me vendet tjera në Evropë.

Progresi është i mundur, por ndryshimet duhet të fillojnë pa

vonesë. Së pari, qasja e përgjithshme ndaj arsimimit multietnik duhet të modifikohet. Pengesa kryesore për arsimimi multietnik në Kosovë duket të jetë mungesa e një qasje gjithëpërfshirëse. Shumica e shembujve të përmendur pozitiv në fillim të këtij artikulli ishin më tepër iniciativa ad hoc se sa përpjekje sistematike dhe të planifikuara mirë.

Autoritetet arsimore shpesh përdorin si argument mungesën e vullnetit për bashkëpunim me komunitet pakicë e cila është pengesa kryesore për përfshirjen e komuniteteve pakicë në sistemin e përgjithshëm arsimor në Kosovë. Por a kanë bërë mjaft autoritetet arsimore për t'u treguar komuniteteve pakicë që ata janë me të vërtetë të rëndësishme për qeverinë?

Ku janë udhëzimet për mësimin e gjuhës shqipe për nxënësit minoritarë të cilat është dashur të përgatiten në dhjetor të viti 2003? Prindërit kosovarë akoma janë duke pritur për një planprogram të unifikuar dhe jodiskriminues për të gjithë nxënësit në Kosovë, i cili do të rrespektonte kulturën dhe traditat e të gjitha komuniteteve. Komunitet më të vogla në Kosovë janë akoma duke pritur për libra shkollorë të standardizuar në gjuhët e komuniteteve pakicë.

Prindërit nuk kanë dëshirë të presin më shumë, sepse kemi pritur mjaft. Vullneti politik i prezantuar shpesh për progres në krijimin e një arsimimi multietnik është i rëndësishëm, por jo më i mjaftueshëm. Ky vullnet i mirë dhe këto premtime verbale duhet të transformohen në të arritura të vërteta për një të ardhme më të mirë për të gjithë fëmijët e Kosovës të cilësdo përkatësi etnike. E ardhmja e përbashkët duhet të ndërtohet së bashku dhe menjëher.

<sup>11</sup> <http://www.ohchr.org/english/law/education.htm>

<sup>12</sup> <http://www.ohchr.org/english/law/minorities.htm>

# Ligji kundër Diskriminimit – përfshirja e sektorit privat

Ligji kundër Diskriminimit qartë e përcakton se për respektimin e të drejtat të tjerëve, duhet ta përkujdeset jo vetëm qeveria, por edhe të gjithë njerëzit. Diskriminimi në baza gjuhësore është i ndaluar me ligj. Megjithatë, në praktikë ende ka nevojë për përmirësime të mirëfillta dhe të qëndrueshme si në promovimin ashtu edhe në njohjen dhe pranimin e të drejtave gjuhësore. Së këndejmi, autori jep sugjerime për disa hapa që duhet të ndërmerren për t'i avancuar të drejtat gjuhësore në Kosovë dhe për të vazhduar punën rreth arritjes së objektivave të Ligjit kundër Diskriminimit: [1] zbatimi i ligjit si prioritet për IPVQ-të; [2] zhvillimi i legjislacionit dhe politikave të qarta për t'i siguruar të drejtat gjuhësore për të gjithë në Kosovë; [3] të saktësohen obligimet e sektorit privat dhe minimumi i standardeve që duhet t'i respektojë nga ky sektor; dhe [4] të zhvillohet një partneritet i njëmendët dhe i fuqishëm ndërmjet qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit afarist, i cili i përkrahë proceset e respektit dhe tolerancës dhe njëherit ka për qëllim që t'i vejë të pah avantazhet që sjell kjo për të gjithë.

Paul Miller

Kryesues i Ekipit të Kosovës, Zyra e Komisionerit të lartë të Kombeve të Bashkuara për të drejta e njeriut



Një nga atributet më të rëndësishme të çdo të drejte të njeriut është se ajo duhet të jetë e rregulluar me ligj. Kjo do të thotë se organi gjyqësor mund të hetojë dhe të vendosë nëse të drejtat e individit ose grupit të njerëzve janë shkelur, dhe nëse kjo konstatohet, të urdhërojë sanksione dhe veprime korrigjuese, të cilat janë të detyrueshme me ligj.

Me rastin e miratimit të Ligjit kundër Diskriminimit<sup>1</sup> Kuvendi i Kosovës ka bërë një hap të rëndësishëm. Ligji, në mes tjerash, e përcakton edhe se si mund të rregullohet me ligj liria nga diskriminimi në baza etnike, gjinore, të moshës, apo edhe në baza gjuhësore. Njëherit, Ligji e plotëson Kornizën Kushtetuese, rregulloret dhe ligjet tjera, të

cilat parashohin që, nga njëra anë, mekanizmat ndërkom-bëtarë të të drejtave të njeriut (përfshirë edhe ato që pengojnë diskriminimin), duhet të respektohen nga ata që mbajnë poste publike, por nga ana tjetër nuk ofrojnë një kornizë të qartë mbi atë sesi mund të aplikohen këto mekanizma në praktikë.<sup>2</sup> Duhet pranuar se miratimi i këtij ligji ishte një hap shumë me rëndësi, por që ka implikime të mëdha. Ndërsa, tani lipset që të kemi një vazhdimësi të qëndrueshme sa i takon realizimit të të drejtave gjuhësore – një proces ky që është inicuar nga IPVQ-të, por i cili kërkon mbështetje të vazhdueshme. *Miratimi i Ligjit kundër Diskriminimit paraqet një hap shumë të rëndësishëm; tani, ekziston nevoja për një vazhdimësi të qëndrueshme, që gjithashtu ka të bëjë me të drejtat gjuhësore.*

Thënë shkurt, hyrja në fuqi e Ligjit kundër Diskriminimit në shtator të vitit 2004, bëri të mundur që të kemi mekanizma zbatues, përcaktim të gjobave (deri në €2,000) dhe mundësi për masa të tjera preventive apo rregullative, të cilat mund të urdhërohen nga gjykatat apo

organet administrative. Këtu përfshihen jo vetëm autoritetet qeveritare të Kosovës, por edhe kompanitë private (të vogla apo të mëdha) dhe qytetarët. Ky ligj qartë parasheh që *përgjegjësia e respektimit të së drejtës së tjetrit nuk bie vetëm mbi qeverinë, por edhe mbi të gjithë personat qofshin ata "posedues të drejtave" apo "bartës të detyrave".*

Në lëminë e gjuhës, e cila është aq fundamentale për jetën dhe punët e përditshme, implikacionet janë shumë të mëdha. Siç vihet në dukje edhe në nenet tjera mbi çështjen e gjuhës,<sup>3</sup> ligjet apo rregulloret e reja për përdorimin e gjuhës në Kosovë janë urgjentisht të nevojshme, të shoqëruara edhe me proceset adekuate të këshillimit mes qeverisë, shoqërisë civile dhe opinionit publik për të siguruar efektivitetin e tyre. Hartimi i këtyre ligjeve të reja do të jetë kontribut i një rëndësie të veçantë drejt rregullimit të të drejtave gjuhësore me ligj, përmes definimit të kushteve minimale për ofrimin e shërbimeve apo qasjen në shërbime në gjuhët e përdorura në Kosovë, dhe dispozitave për rritjen e qartësisë dhe sigurisë në ligj.

## "Kulaçi dhe kërbacı"

Pas plotësimin të kësaj nisme për rregullimin me ligj dhe parashikimit të mundësisë për masa ndëshkuese, të cilat ndryshe mund t'i quajmë edhe si "kërbaç"-- një metaforë kjo e gjuhës angleze, e cila sqarohet përmes situatës kur një djalë e detyron gomarin që të punojë herë duke e rrahur me kërbacı e herë duke ia futur kulaçin para hundës gomarit-- ndaj mund të thuhet se edhe politika gjuhësore po ashtu ka nevojë për "kulaç".

## "Bartësit e përgjegjësive" dhe "poseduesit e të drejtave"

Në terminologjinë e të drejtave njerëzore të gjithë janë "posedues të të drejtave", duke siguruar në këtë mënyrë ca të drejta elementare, universale dhe të patjetërsueshme me vetë faktin se janë pjesë e racës njerëzore. Ndërkaq, në kontekstin e gjuhëve kjo mund të ketë domethënie e nën grupit të të drejtave që kanë të bëjnë me lirinë e fjalës, lirinë nga diskriminimi dhe barazinë përpara gjykatave dhe tribunaleve. Kurse, në rastet kur në një

<sup>1</sup>) Ligji nr. 2004/3, i miratuar nga UNMIK-u Rregullorja 2004/32 e datës 20 gusht 2004. Ligji hyri në fuqi me 19 shtator 2004.

<sup>2</sup>) Shih, p.sh, Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin e Zbatueshëm në Kosovë dhe Rregulloren e amendamentuar të UNMIK-ut 2000/59, kapitlinë 2 dhe 3 të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/19 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetqeverisjen e Përkohshme.

<sup>3</sup>) Shih "Elementet e një Ligji mbi Përdorimin e Gjuhës" dhe "Gjetja e një balansi në mes të kërkesave të pakicave për të drejta dhe burimeve qeveritare"

territor përdoren gjuhë të ndryshme, standardet e të drejtave njerëzore mund t'u shtohen në masë të ndryshme të drejta të tjera si për arsim dhe qasje në shërbime publike në disa gjuhë, të drejta kulturore shtesë dhe të drejta shtesë për lirinë e fjalës dhe informatave që janë specifike për gjuhët e tyre.<sup>4</sup>

Këtu koncepti "posedues i të drejtave" është po ashtu interesant. Në të shumtën e rasteve "bartës të përgjegjësive" nënkuptohen autoritetet publike. Por, në mund të mësojmë edhe nga përvoja e Afrikës, Kartës Afrikane mbi të Drejtat Njerëzore dhe të Popujve, e cila ka shkuar edhe më tutje se standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Kështu, kjo Kartë përmban një kapitull të veçantë mbi detyrat, ku thuhet se "çdo individ e ka për detyrë dhe obligim që t'i trajtojë të tjerët pa diskriminim, dhe të mbajë aso raportesh, të cilat bëjnë të mundur promovimin e respektit të ndërsjellë dhe tolerancës."<sup>5</sup>

Ndërsa, konteksti gjuhësor dëshmon më së miri për atë se ne të gjithë jemi "bartës të përgjegjësive". Kësisoj, neni 4 i Ligjit kundër Diskriminimit ("Lëmia e Implementimit") qartazi vë në dukje se të gjithë janë si "bartës të përgjegjësive" ashtu edhe "poseduesit e të drejtave". Sipas këtij neni ky ligj zbatohet ndaj "të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat çënojnë të drejtat e personit/ve fizik dhe juridik". Lista e fushave që është specifikuar në nenin 4, përfshinë shumë veprime që zakonisht i përkasin sektorit privat si fjala vjen qasja në vendbanim, të mira materiale dhe shërbime dhe në vende publike (të cilat mund të ndërliken me çështje gjuhësore).

## Roli i sektorit privat

S'ka pikë dyshimi se sektori privat – në të shumtën e herave bizneset, por në disa raste edhe individët- ka një rol të caktuar. Së këndejmi, qeveria duhet t'i ndihmojë sektorit privat, duke ia sqaruar legjislacionin dhe obligimet e tjera që ndërliken me aspektin gjuhësor dhe aspektet të tjera kundër diskriminimit, e që kanë të bëjnë me sektorin privat, p.sh- t'ua bëjë të qartë kur ata rrezikojnë të ndëshkohen me "kërbaç". Pa përdorimin e parave publike, përmes kontratave publike, këto obligime mund të jenë më të kufizuara se sa në sektorin publik. Megjithatë, është e qartë se do të ketë kërkesa minimale, siç është kërkesa për trajtim të barabartë në punësim si dhe aftësitë gjuhësore të aplikantëve dhe punonjësve. Fjala vjen, mosnjohja perfekte e gjuhës në të cilën punohet nuk do të duhej të ishte arsye për ta refuzuar një aplikant, që përndryshe është i barabartë, nëse përgjegjësitë e atij posti janë relativisht të thjeshta dhe nëse me këtë post nuk ndërliken probleme të sigurisë.

Veç kësaj, diskriminimi në baza gjuhësore ndalohet edhe kur është fjala për furnizim me mallëra dhe artikuj të nevojshëm. Kështu, nëse një dyqanxhiu refuzon që ta shërbejë një konsumator për shkak të gjuhës së tij/ saj, atëherë kjo do të konsiderohet shkelje e ligjit, ndaj dhe dyqanxhiu do të rrezikojë që të ndëshkohet. Mirëpo, shtrohet pyetja, deri ku duhet të shkojë tregtarja? Çfarë dhe sa informata duhet të sigurojë tregtari për këto mallëra, në gjuhët e Kosovës? Mbase do të ketë nevojë për kërkesa shtesë, siç janë vënia e tiketave në barëra dhe mallëra të tjera të rrezikshme në shumë gjuhë, jo për shkaqe shëndetësore por edhe për shkak të sigurisë dhe të trajtimit të barabartë. Kjo është pika ku e drejtat për shëndetësi

takohen me të drejtën kundër diskriminimit. Në këto raste mbase Ligji kundër Diskriminimit nuk është më i rëndësishmë ngase këtu mund të aplikohen edhe legjislacione të tjera. Janë pikërisht këto dilema që duhet të qartësohen përmes politikave të qëndrueshme, informatave dhe iniciativave legjislative të drejtura nga PSSP-ja.

Veç kësaj, zbatimi i politikës së "kërbaçit dhe kulaçit" mbetet akoma një sfidë jo vetëm për qeverinë por edhe për bizneset. Mirëpo, ideale do të ishte po të mund të përmbushej dhe realizohej parimi i parashikuar në nenin 2 të Ligjit kundër Diskriminimit, i cili i referohet "mirëkuptimit...dhe tolerancës ndëretnike në Kosovë" deri në atë masë sa që bizneset të kuptojnë se është në interesin e tyre që të gjitha aktivitetet si shitja, ofrimi i informatave dhe shërbimeve dhe punësimi i stafit, të zhvillohen në të gjitha gjuhët e Kosovës, nagse kjo do t'ua bëjë të mundur që ta rrisin aktivitetin tregtar dhe shkëmbimet e tjera gjer në maksimum. Vlen të vihet në dukje se në të vërtetë mënyra se si është formuluar neni 2 i gjason mjaft Kartës afrikane, që u përmend më sipër, e që sërish vë në dukje se të drejtat dhe obligimet kanë të bëjnë me mundësitë për përfituar të gjithë. Pos kësaj, mirëkuptimi dhe toleranca ndëretnike janë ngushtë të lidhura edhe me çështjet gjuhësore në Kosovë.

Së këndejmi, përpjekja për të siguruar "kulaçin" si dhe ndihma për të shmangur mundësinë që sektori privat të ndëshkohet me "kërbaçin" nënkupton impenjimet e koordinuara të PSSP-së dhe ministrive si dhe angazhimin e qeverisë dhe sektorit privat në fushën e trajtimit të barabartë. Shpresojmë se ky partneritet do të sëndërtohet në një të ardhme jo shumë të largët, qoftë

si rezultat i iniciativës së PSSP-së apo edhe kur sektori privat ta hetojë rrezikun nga "kërbaçi" apo thënë me një optimizëm më të madh kur sektori privat t'i shohë mundësitë që i hapen dhe i ofrohen nga thyerja e barrierave ndërmjet komuniteteve dhe përdorimi i shlrshëm i gjuhëve të tyre. Shpërblimi për bizneset që tregojnë dhe ndërmarrin iniciativa në promovimin shkëmbimeve të këtilla, ndonëse nuk është një ide origjinale, do të ishte një fillim i mirë. Mbase bizneset të cilat tregohen të sukseshme në praktikë në rritjen maksimale të tregjeve të tyre duke iu afruar të gjithëve në Kosovë, do të shërbejnë si shembuj më të mirë se sa bizneset që ndëshkohen për praktika dhe veprime diskriminuese.

Në fund, do të doja të vejë në dukje edhe disa hapa dhe masa që do të ishin të domosdoshme për t'i avancuar të drejtat gjuhësore në Kosovë dhe për të siguruar arritjen e këtyre objektivave të Ligjit kundër Diskriminimit:

- Të ruhet si prioritet vënia në jetë e Ligjit nga PSSP-ja me ndihmën dhe përkrahjen e akterëve të tjerë ndërkombëtarë;
- Zhvillimi i legjislacionit dhe politikave që promovojnë dhe i artikulojnë të drejtat gjuhësore të të gjithëve në Kosovë, duke u ndihmuar që këto të drejta t'i bëjnë të zbatueshme si dhe duke ndihmuar sektorin privat dhe sektorin publik për t'i përmbushur obligimet e tyre; dhe
- Zhvillimin e një partneriteti të fuqishëm ndërmjet qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit të biznesit, i cili e mbështet procesin e respektimit dhe tolerancës dhe njëherit i cili e ka për qëllim final normalizimin e shkëmbimeve.

<sup>4</sup> Shih, p.sh, Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës, Konventën Kornizë mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave dhe Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale apo Minoritare.

<sup>5</sup> Unioni Afrikan, Karta Afrikane mbi të Drejtat Njerëzore dhe të Popujve, neni 28.

# Gjetja e një balansi në mes të kërkesave të pakicave për të drejta dhe burimeve qeveritare

Katër parime udhëheqëse paraqesin formulën drejt një politike të duhur qeveritare mbi përdorimin e gjuhës: qartësia në legjislacion; zbatimi proporcional; efikasiteti i institucioneve; dhe mjete për detyruar pajtueshmërinë nga autoritetet. Këto parime dalin nga përvoja pozitive e vendeve të Europës dhe vendeve tjera me shumë komunitete gjuhësore. Ky shkrim shpjegon arsyeshmërinë prapa secilit parim dhe hulumton shembujt specifik se si këto parime janë vënë në praktikë në vendet “ku gjërat vajnë mbarë” duke paraqitur në këtë mënyrë alternativat e mundshme për Kosovën.

Dr Fernand de Varennes, Ligjërues i lartë, Universiteti Murdoch, Australi



*Dr. De Varennes flet mbi të drejtat gjuhësore të komuniteteve në Konferencën “Drejt një Pax Linguistica në Kosovë? Të drejtat gjuhësore të komuniteteve të Kosovës”, 14-15 shtator 2004*

Kur flitet për zgjidhje të mundshme dhe praktika më të mira dhe se si qeveria mund të pajtojë apo të balancojë kërkesat mbi gjuhën dhe konsideratat praktike, p.sh. burimet në dispozicion, ka një numër leksionesh që mund të mësohen nga vende të ndryshme të Evropës.

Sidoqoftë, është e nevojshme që ta kemi në mendje një princip themelor: praktikat më të mira duhet të maten kundrejt atyre që konsiderohen standarde të aplikueshme. Këto janë të drejtat gjuhësore me të cilat duhet të pajtohen qeveritë evropiane duke ratifikuar marrëveshje të ndryshme sikurse për shembull Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Konventa Kornizë mbi Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Praktikrat më të mira janë asgjë përderisa nuk keni një njësi matëse.

Kjo do të thotë që jo çdo politike gjuhësore është e mirë, e për-

shtatshme apo efektive. Ajo që do të funksionojë duhet të jetë qartazi në përputhshmëri me standarde e ndryshme të të drejtave gjuhësore që janë të aplikueshme sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe evropiane.

Për të përmbledhur cilat janë modelet pozitive dhe negative nga vendet të cilat kanë përgjithësisht praktika të mira, por jo të përkryera, si Kandaja, Finlanda, Italia, Zvicra, Spanja apo Hungaria, mund të përshkruhen këto elemente të përbashkëta:

1. Qartësia në legjislacion
2. Proporcionalitet në aplikim
3. Efikasitet të institucioneve
4. Mjete për të detyruar pajtueshmërinë

Qartësia në legjislacion do të thotë që në mënyrë që këtë qartësi dhe siguri, të drejtat gjuhësore të të gjithëve duhet të jenë qartazi të shprehura në legjislacion. Mungesa e qartësisë apo kontradiktat mbi të drejtat e individëve apo të komuniteteve mund të sjellin deri te frustrimi, zemërimi apo edhe më keq. Vendet të cilat kanë ligje që shpjegojnë në detaje apo në mënyrë shumë të qartë cilat gjuhë mund të përdoren dhe nën të cilat kushte, janë ato që punojnë më së miri sipas shumicës së kriterëve. I tillë është definitivisht rasti me vendet si Kanadaja, Finlanda, Spanja apo Zvicra.

Kur keni mungesë të qartësisë, bëhet që gjërat nuk ndodhin, sepse autoritetet, duke përfshirë edhe ato komunale, nuk e dinë saktësisht se çfarë duhet të bëjnë

dhe gjithmonë në mënyrë legjitime pretendojnë se nuk kanë shkelur ndonjë obligim.

Mund të ketë konfuzion e bile edhe kontradikta serioze për të drejtat gjuhësore në Kosovë. Për shembull, Plani i Implementimit të Standardeve për Kosovën përshkruan shumicën e të drejtave gjuhësore në seksionin mbi përdorimin e lirë të gjuhës. Ka një princip të aplikueshëm që të gjitha dokumentet dhe përkthimi për mbledhjet zyrtare, në komunat ku ka një komunitet në “numër të konsiderueshëm”, duhet të sigurohen në gjuhën e atij komuniteti.

Në të vërtetë kjo është e paqartë sepse ajo çfarë përbën një numër të konsiderueshëm duhet të identifikohet në mënyrë specifike, por edhe më serioze është problemi që kjo është në kundërtënie me Rregulloren e UNMIK-ut 200/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë që në seksionin 9.3 thotë që kur është e nevojshme, në komunat ku jeton një komunitet, gjuha e të cilit nuk është as shqipja as serbishtja, të gjitha dokumentet zyrtare të komunës duhet poashtu të vihen në dispozicion në gjuhën e atij komuniteti. Sipas kësaj rregullore, nuk ka nevojë fare për “numër të konsiderueshëm”, por më saktë aty ku është “e nevojshme”. Por Plani i Implementimit të Standardeve për Kosovën thotë që komunat duhet ta bëjnë këtë vetëm kur ka numër të konsiderueshëm. Është e padefinuar ajo çka është e nevojshme dhe

nuk është e njëjtë me situatën që merr parasysh numrin e konsiderueshëm, e cila poashtu nuk është e definuar. Këto dy janë në kundërtënie me njëra tjetrën dhe mund të çojnë vetëm deri te konfuzioni, mospajtimet dhe zënkat se kush duhet të bëjë çfarë dhe nuk është rrugë e praktikave më të mira.

Nëse e krahasoni këtë me praktikrat e mira si në Kanada apo Finlandë, asnjëra nuk lënë hapësirë dyshim apo hutitë. Për shembull, Kanadaja, ka rregullore për një qasje në formë të “shkallëzimit dinamik” duke përfshirë ose numrin total ose përqindjen e folësve të anglishtes apo frëngjishtes dhe llojin e shërbimit të ofruar nga autoritetet publike. Përpos në disa fusha kyçe, ku shërbime minimale duhet të jenë në dispozicion kudo në anglisht dhe frëngjisht, shumica e shërbimeve qeveritare federale janë në dispozicion në të dy gjuhët kur popullata në një nën-ndarje të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë përfshinë së paku 5 përqind të folësve apo së paku 5000 individë në qytetet e mëdha që kanë një popullatë më të madhe se 100,000 njerëz. Në disa nën-ndarje të regjistrimit të përgjithshëm më pak të populluara, ca shërbime mund të mirren në të dy gjuhët, edhe nëse ka vetëm 500 folës të gjuhës zyrtare të minoritetit.

Brenda administratës publike të Komunitetit Autonom Bask në Spanjë, gjuha euskara dhe kastiljane duhet të përdoret nga njësitë

administrative në zonat ku përqindja e folësve të euskarës arrin 20 përqind të popullatës. Në Finlandë, një komunë konsiderohet njëgjuhësore – për gjuhën finlandeze apo suedeze – kur e tërë popullata flet të njëjtën gjuhë apo kur numri i banorëve që flasin gjuhën minoritare është më pak se 8 përqind. Nëse minoriteti kalon numrin prej 8 përqind apo 3000 persona, komuna është dygjuhësore. Një komunë dygjuhësore nuk deklarohet njëgjuhësore përderisa numri i minoritetit bie deri në 6 përqind. Është e rëndësishme të përmendet që këto qasje në pjesë të ndryshme të botës janë të mbështetura në ligje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të qarta. mbi përdorimin e gjuhës

Sidoqoftë, të keni qartësi në legjislacion dhe rregullore nuk është e mjaftueshme; vendet që demostrojnë praktikën më të mirë janë ato ku keni proporcionalitet në të drejtat gjuhësore që duhet të jenë të siguruara. Asnjë nga vendet që shihen zakonisht si më të efektshme dhe mirë të organizuara nuk përdorin gjuhët e përdorura nga të gjithë, gjithkrah dhe gjatë gjithë kohës në dokumente zyrtare dhe në zyra administrative. Do të ishte e pamundshme dhe jopraktike për të bërë një gjë të tillë, sepse në shumë vende si Kanadaja apo edhe Spanja ka një dyzimin gjuhësh të foluara në territoret e tyre. Poashtu do të kush-tonte jashtëzakonisht shumë dhe asnjë vend nuk është aq i pasur apo i aftë ta bëjë këtë në mënyrë praktike.

Ajo se çfarë bëjnë qeveritë, aty ku politika gjuhësore punon mirë, është para së gjithash të aplikojnë një “shkallëzim dinamik”; të ofrojnë një shkallë përdorimi të një gjuhe nga autoritetet administrative, duke përfshirë edhe komunat, që është proporcionale me rëndësinë relative të aspektit numerik.

Kanadaja zakonisht presentohet të ketë vetëm dy gjuhë zyrtare, dy gjuhët që fliten nga më së

shumti njerëz në atë shtet. Sidoqoftë, gjuhët tjera janë të përdorura nga autoritetet publike sikurse gjuhët e popujve autoktonë që poashtu janë gjuhë zyrtare për qeverinë territoriale të Nunavut-së. Poashtu, gjuhët tjera indigjene përdoren në pajtim me ligjet dhe rregulloret e qeverive lokale kur fliten nga një numër i mjaftueshëm i njerëzve. Principi i rëndësishëm këtu është jo të gjitha gjuhët trajtohen në mënyrë identike: gjuhët që fliten nga më shumë njerëz duhet të trajtohen në proporcionalitet me rëndësinë e tyre. Kjo duhet të përfshihet në legjislacion të qartë në mënyrë që të evitohen mospajtimet, konfuzioni apo konflikti.

Vendet që zakonisht shihen si të suksesshme jo vetëm që kanë qartësi në legjislacion the proporcionalitet në aplikim, por gjithashtu duket të kenë efikasitet në institucione. Ato kanë mekanizma dhe institucione të sigurojnë që ligjet mbi gjuhën kuptohen, aplikohen dhe zbatohen në mënyrë efektive

Për shkak se të drejtat gjuhësore kërkojnë investime në struktura dhe shpenzime për qeveritë, vendet si Kanadaja, Zvicra dhe të tjerat kanë një numër të institucioneve apo mekanizmave të ndryshëm

Në Zvicërr, të drejtat gjuhësore janë parimisht të garantuara përmes institucioneve të qeverive kantonale, një situatë e ndjekur edhe në Bosnë dhe Hercegovinë. Duke pasur shumë, nëse jo të gjitha, nga detyrat administrative të deleguara në nivel të kantonave, të cilat janë të prera në mënyrë të tillë që janë në thelb njëgjuhësore, të drejtat gjuhësore të shumicës së njerëzve janë të rrespektuara në praktikë.

Në mungesë të një strukture shumë të decentralizuar, atëherë duhet të ketë institucione dhe mekanizma që të sigurojnë që të drejtat gjuhësore që janë të garantuara në ligj, në të vërtetë aplikohen. Vendet si Kanadaja apo Finlanda mund të kenë një

departament të veçantë qeveritar që ka përgjegjësinë e përgjithshme për të mbikqyrur aplikimin e ligjit për përdorim të gjuhëve. Ministri për atë departament mund të ketë përgjegjësinë për implementimin e legjislacionit ekzistues dhe shpërndarjes së fondeve sikurse edhe t’i dorëzojë parlamentit një raport çdo vit duke treguar ku ka pasur përmirësime apo probleme në praktikimin e legjislacionit gjuhësor. Në Kanada, është Bordi i Thesarit i cili ka përgjegjësinë për zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe programeve të lidhura me komunikimin dhe shërbimin ndaj publikut. Qartazi kjo përfshinë gjuhën në të cilën publiku e pranon këtë shërbim, duke përfshirë këtu edhe atë nga autoritetet administrative. Në këtë mënyrë ai ka një përgjegjësi fundamentale që të ketë mekanizma për të mbikqyrur se si do të vëhet në jetë politika gjuhësore – dhe si do të paguhet ajo politikë.

Një qasje edhe më e fortë institucionale do të ishte të ketë një “Komisioner për Gjuhët” i cili vepron si një kujdestar në mes të publikut dhe autoriteteve qeveritare që të sigurojë një shkallë më të lartë të neutralitetit dhe të ndihmë individët nëse ata kanë ankesa. Një komisioner mund të ketë fuqi ligjore të veprojnë në mënyrë preventive duke intervenuar në atë fazë kur përgatiten ligjet, rregulloret dhe politikat, në mënyrë që të sigurohet që të drejtat gjuhësore janë shqetësim primar i udhëheqësve. Një komisioner i tillë zakonisht merr fonde të garantuara nga buxheti kombëtar, ka staf dhe zyra, ka autoritet ligjor të hetojë se si janë të implementuara të drejtat gjuhësore dhe mund të raportojë një herë në vit mbi pajtueshmërinë. Një “Ombudsman Gjuhësor” mund të luajë një rol të ngjajshëm në disa vende. Poashtu, zakonisht ka një program arsimimi përmes departamentit përgjegjës për të informuar njerëzit mbi të drejtat e tyre gjuhësore.

Së fundi, shumë nga vendet ku “gjërat shkojnë mirë” janë ato ku keni mjete për të përmirësuar rastet e mospajtueshmërisë nga autoritetet. Me fjalë të tjera, aty ku institucionet e qeverisë dështojnë, çfarë mund të bëjnë individët? Zakonisht ka një numër nivelesh ku mund të gjenden mënyra për të përmirësuar situatën:

- Mund të ketë një mekanizëm administrativ për ankesa që është i mundur po të kemi një zyrtar për ndërlidhje në secilin departament të qeverisë, duke ofruar informacione për tu shpjeguar njerëzve cilat janë të drejtat e tyre. Secili departament e ka për detyrë të hetojë dhe t’i përgjigjet ankesës.
- Zakonisht ka një mekanizëm administrativ më formal dhe më të centralizuar të ankesave që mund të përfshijë departamentin e qeverisë qendrore që ka përgjegjësinë e përgjithshme për politikën gjuhësore. Pra kemi një ankesë dhe një hetim qendror por zakonisht me fuqi për të bërë vetëm rekomandime.
- Një Ombudsperson apo një Komisioner për gjuhë kanë fuqinë të hetojnë ankesa, të bëjnë rekomandime dhe të prezantojnë raporte mbi këto shkelje të të drejtave gjuhësore drejtpërdrejtë parlamentit.
- Ligji (apo në disa raste kushtetuta) mund tu japin mundësinë viktimitave individuale ta ngrisin rastin para një gjykate për shkelje të të drejtave të tyre dhe të ofrojnë atë se çfarë mund të marrin ata në formë të kompensimit.

Zakonisht vetëm kur keni shtete që i kanë këto katër praktika: qartësi në legjislacion, proporcionalitet në aplikim, efikasitet të institucioneve dhe mjete për të detyruar pajtueshmërinë mund të themi që ato kanë praktika të mira që përputhen me standardet që përgjithësisht aplikohen në Evropë në fushën e të drejtave gjuhësore.



# Elementet e një Ligji mbi Përdorimin e Gjuhës

Zbatimi joadekuat i të drejtave gjuhësore në Kosovë për një kohë të gjatë ka treguar nevojën që kësaj çështje i duhet një qasje konstruktive. Për derisa mungesa e vullnetit politik, kufizimet financiare dhe ato strukturale si dhe barrierat shoqërore dhe psikike mbesin ende pengesa praktike, korniza e tashme ligjore, e posaçërisht kjo vlen në fushën e “të drejtave administrative gjuhësore”, paraqitet më tepër si problem sesa si një pjesë e zgjedhjes. Shkrimi argumenton se një i ligj i duhur mbi gjuhët i përpiluar me një pjesëmarrje të gjërë dhe që do të ishte koherent me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, do të mund të siguronte që dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtat gjuhësore të jenë të kuptueshme, të zbatueshme në praktikë dhe të jenë të njohura edhe për qytetarët edhe për institucionet. Një e mirë shtesë në procesin e negociimit në mes të mjeteve të qeverisë dhe kërkesave të pakicave duhet të jetë qëndrueshmëria e garancave ligjore.

Gianfranco D'Eramo, Këshilltarë i Lartë për Çështje të Pakicave, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Marrëdhëniet mes të drejtave të komuniteteve gjuhësore<sup>1</sup> dhe administratës publike në Kosovë qeverisen nga një arkitekturë ligjore e ngatërruar. Korniza Kushtetuese i bën parimet nga dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut<sup>2</sup> drejtëpërsëdrejti të zbatueshme ndërkohë që fushëveprimi dhe modalitetet e zbatimit të tyre janë të rregulluara nga një kornizë ligjore e komplikuar që ngërthen në vete seksionet përkatëse të legjislacionit të ish RSFJ-së<sup>3</sup>, rregulloret e UNMIK-ut<sup>4</sup> dhe Udhëzimet Administrative<sup>5</sup> si dhe Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Teksti ligjor është fare pak udhëzues, kryesisht për shkak të fragmentimit të tij, për ata që janë të thirrur ta vënë në fuqi<sup>6</sup>. Si rezultat, vendimet e marra nga gjykatësit, prokurorët, policia apo administratorët civil për çështje gjuhësore, ngelin arbitrare në esencë.

Menjanimi i arbitraritetit dhe sigurimi i parashikueshmërisë në vendim-marrje kur është fjala për të drejtat gjuhësore ngelet një sfidë urgjente për IPVQ.

Në prill të vitit 2004, Grupi Punues për Pajtueshmërinë mbi Standardet Gjuhësore<sup>7</sup> ka rekomanduar miratimin e një Udhëzimi Administrativ (UA) që do të shërbejë si një “mekanizëm i përkohshëm derisa të përpilohet dhe miratohet nga Kuvendi i Kosovës një Ligj i Veçantë mbi Përdorimin e Gjuhës”. Miratimi i UA do të ishte një hap inkurajues drejt thjeshtësimi të kornizës së tanishme ligjore. Sido që të jetë, duhet të konsiderohet prodhim vendor, për të garantuar qëndrueshmërinë. Cilado politikë e propozuar gjuhësore patjetër duhet të debatohet nga institucionet dhe komunitetet e folësve. Sa më i hapur të jetë dialogu, i bazuar në një zgjedhje mire të informuar mbi alternativat e

ndryshme, aq më i qëndrueshëm do të jetë rezultati final. Do të ishte një balans i negociuar mes kërkesave të komuniteteve gjuhësore dhe detyrat, autoriteti dhe mekanizmat e IPVQ do të jenë kuptohen mirë, do të rrespektohen dhe fuqizohen në të ardhmën.

Një proces gjithëpërfshirës që çon në miratimin e Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhës – duke qartësuar kështu cilat gjuhë mund të përdoren në Kosovë, në çfarë kushtesh, çfarë shkalle të mbrojtjes ligjore mund të kenë individët e dëmtuar, në cilat sfera të jetës dhe çfarë mund të jenë sanksionet e parapara në rast të shkeljes së këtyre të drejtave- është një mundësi të cilën Qeveria e re duhet ta kapë.

Ligji duhet së pari të qartësojë statusin ligjor të gjuhëve shqipe dhe serbe. Në kornizën e tanishme ligjore<sup>8</sup>, “Ligji për imple-

mentimin e Barazisë së Gjuhëve dhe Alfabetëve në KSAK”<sup>9</sup> 1977. Ky ligj ka krijuar barazinë e plotë mes gjuhës shqipe dhe serbokroate në tërë territorin e ish KSAK dhe të gjuhës turke në vendet ku “banojnë pjesëtarët e nacionalitetit turk”. Në këtë mënyrë, barazia e plotë mes shqipes dhe serbishtes teoritikisht është krijuar në tërë territorin e Kosovës, ndërkohë që gjuha turke ishte e mbrojtur si “gjuha e minoritetit” në vendet e banuara me turkofolës. Ligji është zëvendësuar në vitin 1991 përmes “Ligjit për përdorimin zyrtar të Gjuhëve dhe Alfabetëve”<sup>10</sup> i cili për shkak të natyrës diskriminuese nuk zbatohet më. Në gjithë legjislacionin e miratuar që nga viti 1999, parimi i barazisë mes gjuhës shqipe dhe serbe ndonëse mire i njohur, nuk është përcaktuar askund.

Korniza Kushtetuese siguron që takimet në Kuvendin e Kosovës

<sup>1</sup> Të drejtat e përdorimit të gjuhës përfshijnë të drejtën e përdorimit privat dhe publik të gjuhës dhe deri në masë të caktuar në kontakt me organet administrative dhe gjyqësore; të drejtën e përdorimit të emrit të vet në gjuhën minoritare dhe të drejtë për pranim zyrtarë të të njëjtit si dhe të drejtë të paraqitjes publike në gjuhën minoritare të mbishkrimeve dhe shenjave të natyrës private dhe nën kushte të caktuara të vëhen mbishkrime topografike në gjuhën e pakicës.

<sup>2</sup> Kaptina 3 nga UNMIK/REG/2001/9.

<sup>3</sup> Ligjet e aprovuara deri në mars të vitit 1989 dhe ato pas viti 1999, nëse nuk janë diskriminuese dhe nuk janë në kundërvitje me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që janë të zbatueshme në Kosovë dhe nuk përkojnë me ligjet tjera në fuqi.

<sup>4</sup> Shih mes tjerash, kaptinat 4.4, 9.3.1.7, 9.1.50-52 nga UNMIK/REG/2001/9, Seksioni 9 nga UNMIK/REG/2000/45, neni 2. 3 nga UNMIK/REG/2001/36, UNMIK/REG/2004/36, etj.

<sup>5</sup> Shih mes tjerash, neni 4.1 nga UNMIK/UA 2003/2, etj.

<sup>6</sup> Vlenë të theksohet se sanksionet për rastet e diskriminimit në – inter alia – bazën e gjuhës vetëm sa janë futur në përdorim me Ligjin kundër Diskriminimit, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004.

<sup>7</sup> Grupi punues i përbërë nga përfaqësues të UNMIK, Zyra për Çështje të Komuniteteve dhe Zyra për Kthim dhe Komunitete, Misioni i OSBE-së në Kosovë, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Shërbimeve Publike.

<sup>8</sup> Rregullores së UNMIK-ut 1999/1 “Mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë”, me 25/7/1999, të ndryshuar nga rregullorja e UNMIK-ut 2000/54, 2/9/2000.

<sup>9</sup> Gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës numër 48/1977, ndryshuar me “Ligjin mbi ndryshimet në ligjin rreth realizimit të drejtës së përdorimit të gjuhës dhe alfabetit në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës (gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës numër. 11/85).

<sup>10</sup> Gazeta Zyrtare e Serbisë . 45/1991.

(në sesione plenare dhe komisione të tij) dhe qeveria (dhe ministrinë e saj) të mbahen në gjuhën serbe dhe shqipe, ndërsa të gjitha dokumentet të shtypen në të dyja gjuhët<sup>11</sup>. Për më tepër, ligjet e miratuara do të publikohen në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe angleze. Shumë pjesëmarrës në konferencën Pax Linguistica, pohuan se shumë nga zbrazëtitat e procesit ligjvënës janë rezultat i drejtpërdrejtë i mosnjohjes së mjaftueshme të konceptit të barazisë mes dy gjuhëve zyrtare në Kosovë. Praktika e përkthimit të akteve administrative dhe ligjore nga shqipja në serbisht dhe anasjelltas, duhet ndaluar në rast se këto dy gjuhë janë të barabarta dhe se asnjëra nuk mund të mbizotërojë gjatë asnjë praktike administrative. Aktet zyrtare, në nivelin lokal dhe qendror, duhet përpiluar dhe publikuar njëkohsisht në të dyja gjuhët. Vetëm në këtë mënyrë cilido akt administrativ mund të ketë legjitimitetin e pakufizuar në tërë territorin e Kosovës. Si efekt anësor, çdo qytetar i Kosovës do të përdorte njërin gjuhë apo tjetrën në çdo aspekt të jetës publike, pa marrë parasysh arsyet për një zgjedhje të tillë apo pa pengese. Si rrjedhojë, shërbyesit civil komunal, stafi mjekësor, zyrtarë të arsimit, policë, gjykatës duhet të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e tyre në njërin nga dy gjuhët.

Pasi të definohet statusi i shqipes

dhe serbishtes, Ligji duhet që në mënyrë të drejtë të definojë edhe statusin e gjuhëve të tjera në Kosovë – boshnjakishtes, kroatishtes, turqishtes, gjuhës rome dhe gorane. Poashtu duhet saktësisht të definojë dispozitat që rregullojnë përdorimin e këtyre gjuhëve në arsim, drejtësi, autoritete administrative, media, aktivitete kulturore, jetën ekonomike dhe shoqërore dhe marrëdhëniet përtej kufirit.

Deklarata Europiane për Gjuhët Regjionale dhe Minoritare<sup>12</sup> ofron udhëzime të veçantë për këtë qëllim. Kjo ngërthen një komponent të parimeve obliguese (Pjesa II) dhe një bagazh dispozitash (Pjesa III), tridhjetë e pesë prej të cilave duhet të zgjidhen nga autoritetet kosovare për të përkthyer këto parime nga pjesa e II<sup>13</sup> në politikë, legjislacion dhe praktika.

Zbatueshmëria e dispozitave të Kartës përfshijnë edhe gjuhët regjionale apo minoritare, të cilat janë (i) përdorur tradicionalisht mbrenda një territori të një shteti nga qytetarë të atij shteti që përbëjnë një grup më të vogël sesa pjesa tjetër e popullatës dhe (ii) të tjera nga gjuhët zyrtare e atij shteti<sup>14</sup> përjashton dialektet e gjuhëve zyrtare dhe gjuhët e emigrantëve. Në rastin e Kosovës, ky definicion lë shumë pyetje pa përgjegje. Për shembull, nuk qartëson nëse gjuha gorane duhet të merret si gjuhë e veçantë apo nëse një variantë

e gjuhës rome ka karakteristikat e të së ashtuquajturës “gjuhë joterritoriale”<sup>15</sup>. Ky definicioni poashtu nuk mund të ndihmojë vendimin nëse dispozita të veçanta janë të domosdoshme për gjuhën kroate apo boshnjake, për shkak të kuptimit reciprok mes këtyre dy gjuhëve. Rregulla e vetme në dispozicion për politikë-bërësit për të vendosur se tek të cilat gjuhë aplikohet Deklarata është besimi i mirë, fleksibiliteti dhe pragmatizmi. Institucionet kosovare duhet të angazhohen në dialog me komunitete të ndryshme gjuhësore dhe bashkarisht të vlerësojnë qëndrimet ndaj kriterëve të ndryshme, përfshirë këtu edhe kontekstin e veçantë të secilës gjuhë, nëse folësit janë të përqëndruar në një territor, nëse gjuhët janë përdorur për një periudhë të gjatë, shkallën e përdorimit të gjuhës, lidhjet me gjuhët tjera regjionale etj. Një numër i madh dokumentesh dhe doracakësh mund të ofrojnë udhëzime shtesë<sup>16</sup>.

Hapi thelbësor është që Ligji të caktojë cilat paragrafe të Pjesës III të Deklaratës duhet aplikuar në gjuhët paraparakisht të definuara regjionale apo minoritare të Kosovës. Përmes përkushtimeve “à la carte”, Deklarata u jep ligjvënësve fleksibilitetin e duhur për të krijuar llojin dhe shkallën e mbrojtjes së gjuhëve minoritare në situatë të ndryshme. Për shembull, sa i përket

arsimimit fillor, Deklarata ofron këto mundësi:

- i) të mundësojë shkollimin fillor në gjuhët përkatëse regjionale dhe minoritare; apo
- ii) të mundësojë një pjesë thelbësore të arsimit fillor në gjuhët përkatëse regjionale apo minoritare, apo
- iii) të mundësojë që në kuadër të arsimit fillor, mësimdhënien e gjuhëve përkatëse regjionale apo minoritare si pjesë integrale të planprogramit, apo
- iv) të zbatojë një nga ato masa sipas pikes i) dhe iii), së paku për ata nxënës familjet e të cilëve kërkojnë një gjë të tillë, apo numri i të cilëve konsiderohet i mjaftueshëm<sup>17</sup>.

Ndërkohë që çdo opcion mund të diskutohet nga IPVQ dhe komunitetet gjuhësore.

Për të arritur deri te një numër minimal i përqindjes së minoritetit gjuhësor, të cilit do ti ofrohen shërbimet, do të ishte fuqizim i kërkesës që të ofrohen edhe referencat primare dhe objektive atyre që krijojnë politikë. Me fjalë të tjera, aty ku insitucionet përballen me numër të mjaftueshëm të individëve që përdorin një gjuhë, ato autoritete duhet të ofrojnë një shkallë të duhur të shërbimeve në atë gjuhë. Dr. De Varennes sqaroi këtë parim sipas, siç e quajti ai, “shkallëzimit dinamik”:

<sup>11</sup> Shih seksioni 9.1.49 dhe 9.3.17 nga UNMIK/REG/2001/9

<sup>12</sup> Deklarata e Këshillit të Europës mbi Gjuhët Rajonale dhe Minoritare e 5 nëntorit 1992 hyri në fuqi më 1 mars të vitit 1998. Që nga 15 korriku i vitit 2004, Deklarata është ratifikuar nga 17 shtete, përfshirë Armeninë, Austrinë, Kroacinë, Qipronë, Danimarkën, Finlandën, Gjermaninë, Hungarinë, Lihtenshtajnin, Holandën, Norvegjinë, Slovakinë, Sloveninë, Spanjën, Suedinë, Zvicrën dhe Mbretërinë e Bashkuar.

<sup>13</sup> Tetë principe fundamentale janë të përfshira në Nenin 7 të Deklaratës së Këshillit të Europës mbi Gjuhët Rajonale dhe Minoritare. Këto janë: 1) Njohja e gjuhëve minoritare apo rajonale si pasuri kulturore; 2) Respektimi i hapësirës geografike për secilën gjuhë regjionale apo minoritare; 3) Nevoja për ndërmarrjen e veprimit për të promovuar ato gjuhë; 4) Ndhimesa dhe inkurajimi i përdorimit të gjuhëve të tilla, në të shkruar, folur dhe jetën private dhe publike; 5) Sigurimi i formave dhe mjetet të përshtatshme të mësimi dhe studimit për këto gjuhë në të gjitha nivelet adekuate; 6) Promovimi i këmbimeve përkatëse transnacionale; 7) Ndalimi i të gjitha formave të dallimit të padrejtë, mospërfshirjes, preferencave apo restriksionit që ka të bëjë me gjuhët regjionale dhe minoritare me qëllim të dekurajimit apo rezikimit të zhvillimit të këtyre gjuhëve; 8) Promovimi nga shtetet që kanë mirëkuptim reciprok mes të gjitha grupeve gjuhësore të vendit.

<sup>14</sup> Ibidem, Art.1 (a).

<sup>15</sup> “Gjuhët jo territoriale” kanë të bëjnë me gjuhët që përdoren nga shtetas të atij vendi gjuha e të cilëve ndryshon nga gjuha që përdor popullata tjetër, e cila ka përdorur këtë gjuhë tradicionalisht mbrenda territorit të atij shteti dhe gjuhët joterritoriale nuk identifikohen me atë territor”, ibidem, Art 1 (c).

<sup>16</sup> Shih mes tjerash, Rekomandimet e Hagës që kanë të bëjnë me të drejtat arsimore të minoriteteve me një shënim sqarues (1996), Rekomandimet e Oslos që kanë të bëjnë të drejtat gjuhësore në Media (2003) dhe janë në dispozicion në : <http://www.osce.org/hcnm/documents/recommendations/index.php>



*Shenja për Krishtilindjet e vendosur nga komuna e Prishtinës, vetëm në shqip dhe anglisht*

Duke filluar në nivelin më të ultë [...] zyrtarët publik duhet së paku të kenë dokumente zyrtare dhe formularë në vendet ku ekziston një numër i vogël por i mjaftueshëm i folësve të gjuhës minoritare. Me rritjen e numrit të folësve, përveç dokumenteve dygjuhësore apo në gjuhën e pakicave,, zyrtarët publik do të duhet të praninin dhe të përgjigjeshin në aplikacionet e mbushura në gjuhën e pakicave. Në shkallën më të lartë do të duhej të qëndronte një lloj administrate dygjuhësore në rrethet ku gjuha minoritare përdoret nga një përqindje e lartë e popullsisë. Kjo do të thontë se do të duhej të kishte numër të domosdoshëm të zyrtarëve publik që janë në kontakt me qytetarët dhe kanë mundësi që të përgjigjen në gjuhën jozyrtare apo minoritare edhe në rajonet ku gjuha minoritare përdoret si gjuhë interne dhe si gjuhë e përditshme në punë me autoritetet publike.<sup>18</sup>

Është me rëndësi të thuhet se Ligji mbi Përdorimin e Gjuhës do të duhej t'i definonte qartë sanksionet në rastet e moszbatimi-

mit. Neni 44 i ligjit të RSFJ-së nga viti 1977 i ka parashikuar dënimet deri në 20,000 dinarë për zyrtarët publik të cilët do të shkelnin dispozita të ndryshme gjatë zbatimit të detyrave të tyre. Një shembull më i freskët është Ligji kundër Diskriminimit, i cili parashih një sërë gjobash për personat fizik ose juridik që dëshmojnë se e shkelin ligjin dhe përcakton kompensimet për dëmet materiale dhe jo-materiale që u janë shkaktuar viktimave nga këto shkelje.<sup>19</sup> Në vlerësimin e ashpërsisë së dënimeve, sipas përvojës që do të duhej ta kishin parasysh hartuesit është se sanksionet duhet të jenë bindëse, efikase dhe proporcionale me shkeljen e bërë. Fyerjet do të duhej të sanksionoheshin në pajtim me natyrën dhe qëllimin e shkeljes, përdërisa dënimet më të mëdha do të duheshin marrë parasysh në rastet kur kryesit e shkeljeve veprojnë me qëllim kriminal si p.sh., urrejtja etnike.

Çështja përfundimtare të cilën do të duhej t'i adresohet Ligji

është vlerësimi i politikave të përcaktuara. Sistemi i rregullt i monitorimit dhe zbatimit të Ligjit është një instrument shumë i dobishëm si për Qeverinë, në mënyrë që ta vlerësojë pajtueshmërinë me politikën gjuhësore, ashtu edhe për qytetarët pasi që vështrimi i publikut është një nga parimet fundamentale për një shoqëri demokratike. Duhet të mandatohet një vlerësim periodik, që do ta rregullonte shpeshësinë dhe modalitetet e raportimit për zbatimin e dispozitave të ndryshme. Mund të themelohet një organ i pavarur ose gjysëm-qeveritar dhe t'i jipet detyra për të organizuar dhe zbatuar vlerësimet e rregullta të politikave të miratuara. Ky organ do të hartonte raporte duke përfshirë edhe rekomandime për Qeverinë dhe konkludimet e tyre do të mund të viheshin në dispozicion të organeve tjera dhe publikut më të gjerë.

Në fazën fillestare të implementimit do të ishte e dobishme që të vendoset një cikël i ngushtë i raportimit por edhe duke harmonizuar me kërkesat ekzistuese për raportim mbi zbatimin e të drejtave gjuhësore<sup>20</sup> gjithashtu mund të jetë i dobishëm. Gjithashtu ia vlen të kujtohet se një mekanizëm i raportimit është poashtu i parashikuar nga Deklarata, duke i përcaktuar obligimet raportuese mbi pajtueshmërinë e shteteve anëtare me dispozitat e saj, ku raportet ekzaminohen nga Komisioni i ekspertëve<sup>21</sup> që jep konkluzione joobligative. Harmonizimi i këtyre cikleve të raportimit do të garantonte mekanizma për vlerësim të cilësisë dhe shfrytëzim efikas

të resurseve ekzistuese. Përveç kësaj, do të ngritej kapaciteti i IPVQ-ve për t'u ballafaquar me obligimet e ardhshme raportuese, do të thotë të atyre që janë sipas Komisionit të të Drejtave të Njeriut të KB-së mbi të Drejta Civile dhe Politike ose Komisionit të KB-së për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

Shoqëria civile e Kosovës mund të kontribuojë shumë për procesin e promovimit të shumëllojshmërisë gjuhësore përmes hartimit të ligjit. Në veçanti, organizatat joqeveritare (OJQ-të) mund të kenë rolin qendror për t'i asistuar Qeverisë në përzgjedhjen e gjuhëve dhe dispozitave të pjesës III të Deklaratës të cilat mund të zbatohet. Njëlloj, OJQ-të mund t'i ofrojnë informata komisionit të ekspertëve të pavarur të Këshillit të Europës mbi sfidat që mund të paraqiten gjatë procesit të implementimit të ligjit. Bashkësia ndërkombe-tare si tërësi gjithashtu ka një rol të rëndësishëm, jo vetëm në këshillimin e IPVQ-ve gjatë hartimit të ligjeve dhe procesit të implementimit të tyre, por gjithashtu edhe në harmonizimin me politikën e përcaktuara. Në fund, duhet të sigurohen mjetet e domosdoshme financiare, që të mundësohet implementimi i qëndrueshëm i ligjit në të gjitha nivelet dhe të gjithë sektorët.

Një debat i mirëfilltë mbi politikën gjuhësore për Kosovën mund të zgjasë më tepër se sa është pritur. Nuk ka "zgjdhje të shpejta" dhe, si në shumë debate të tjera fundamentale në çdo shoqëri demokratike, procesi është me po aq rëndësi sa edhe rezultati.

<sup>17</sup> Ibidem, Art. 8 (b).

<sup>18</sup> Të drejtat gjuhësore si pjesë Integrale e të Drejtave të Njeriut, Fernand De Varennes, Gazeta e Shoqërive Multikulturore MOST, Vol. 3, N.1, 2.12, 2.13, UNESCO (2001).

<sup>19</sup> Shih Paragrafin 9 të Ligjit kundër Diskriminimit.

<sup>20</sup> Këto përfshijnë Planin për Implementimit e Standardeve për Kosovën ose Konventa Kornizë për Pakicat Kombëtare)

<sup>21</sup> Komisioni i ekspertëve e përgatit dhe ia përcjell Komisionit të Ministrave të Këshillit të Europës raportin e vet, duke i përfshirë edhe propozimet që u jipen shteteve. Pas shqyrtimit të raportit të komisionit të ekspertëve, Komisioni i Ministrave mund të vendosë që ta publikojë atë. Gjithashtu mund të vendosë që të bëjë rekomandime shteteve me pikëpamjet që t'i harmonizojnë veprimet për sajimin e politikave, legjislacionit dhe praktikave me obligimet që i kanë sipas Deklaratës

## Deklarata e Misionit të ASI-t


Si koordinatore e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahin Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësive në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përpunimin në drejtim të arritjes së këtij pikësnyimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjuhësisë në Kuvend.

Si një koordinatore në mes të agjensive që përkrahin Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për krerët e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

### Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

*Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikant Parlamentare Lindje-Perëndim (Holandë) në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Hulumtim të Politikave dhe Zhvillim (KIPRED), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.*



<http://www.kuvendikosoves.org>  
<http://www.skupstinakosova.org>  
<http://www.assemblyofkosovo.org>

**ASI**  
NEWSLETTER

Rruga Beogradi 32, 38000 Prishtinë  
 Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188  
 kontakt: franklin.devrieze@osce.org  
<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t